



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 26/2022 regjistër (JR)
Datë 16.06.2022

Nr. 3 i vendimit
Datë 16.01.2025

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim, fillimisht në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 10.12.2024, ditën e martë, në orën 10:00 dhe më pas në seancë gjyqësore publike, më datë 13.01.2025, ditën e hënë, ora 10.00, dhe shpalli në datën 16.01.2025, ora 15.00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me sekretar gjyqësor Kevin Kovaçica, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Eriselda Bala, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 523, datë 07.04.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 179/b, paragrafi 5; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi dhe në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, shqyrtoi pretendimet dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet e paraqitura para dhe gjatë seancës gjyqësore publike, e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit, nr. 523, datë 07.04.2022 dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes, Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Eriselda Bala (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex-officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka zhvilluar hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, përkatësisht për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në zbatim të përcaktimeve të neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), sipas neneve 31 – 33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar¹ (në vijim “DSIK”), sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016.

2.1. ILDKPKI, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë, i ka dërguar Komisionit Raport-kontrollin,² ku konkludohet se: Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton për subjektin e rivlerësimit, znj. Eriselda Bala, sa vijon:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar mundësinë financiare të familjarëve për shumat e dhëna hua/dhuratë subjektit;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

¹ Kjo strukturë, aktualisht mban emërtimin “Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar”.

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 29.10.2018.

2.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport³ për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, grupi i punës ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Eriselda Bala.

2.3. KLP-ja ka hartuar Raportin për analizimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, të cilin ia ka përcjellë Komisionit⁴.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 523, datë 07.04.2022, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Eriselda Bala, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”*.

4. Vendimmarrja e Komisionit për subjektin e rivlerësimit, znj. Eriselda Bala, është bazuar në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave dhe procedurave që kanë lidhje me këtë kriter, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, të cilat kanë pasjellë aplikimin e nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, duke konkluduar si vijon:

Subjekti i rivlerësimit Eriselda Bala ka kryer:

i) Deklarime të pasakta dhe jo në përputhje me ligjin të burimit të krijimit të pasurive, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Sa i takon mungesave dhe pasaktësive në deklaratat periodike vjetore, arsyetuar hollësisht në këtë vendim, referuar fakteve: (a) mungesës së deklarimeve, si nga subjekti, ashtu edhe nga bashkëshorti i saj, të burimit të krijimit të ½ pjesë takuese të pandarë të bashkëshortit në pasurinë apartament banimi, si dhe (b) deklarimit në mënyrë të përsëritur se, si burime krijimi për të dyja pasuritë e deklaruara në deklaratën vetting kanë shërbyer të ardhura, të cilat subjekti nuk i ka disponuar në momentin e kryerjes së pagesave, në mungesë të deklarimeve dhe sqarimeve në lidhje me burimin real të të ardhurave që kanë shërbyer për këto pagesa [...].

ii) Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të blerë pasurinë apartament banimi, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për shkak të një balance negative prej 5.674.731 lekësh.

iii) Ka kryer deklarime të rreme të burimit të krijimit të pasurisë apartament banimi, sipas parashikimit të germës “ç”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin pasuror, që sipas parashikimit të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, është shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

III. Ankimi i vendimit të Komisionit

5. Kundër vendimit të Komisionit nr. 523, datë 07.04.2022, ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit, znj. Eriselda Bala, nëpërmjet të cilit ka ngritur pretendime në drejtim të cenimit të parimeve të procesit

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. 303, datë 27.10.2020, të KDZH-së.

⁴ Me nr. {***} prot., datë 17.12.2021.

të rregullt ligjor, si dhe kundërshtime të konkluzioneve të Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke kërkuar nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “trupi gjykues”), ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e saj në detyrë.

A. Shkaqe ankimi që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

6. Për automjetin tip “Mercedes Benz”, vit prodhimi 2003, të blerë në vitin 2009, në shumën 11.390 euro, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit si të padrejta, duke pretenduar se: **(i)** për këtë automjet është ngarkuar me barrë prove në tejkalim të parashikimeve ligjore në fuqi; **(ii)** ka provuar në mënyrë të plotë se ka financuar blerjen e tij me burime të ligjshme dhe se konkluzioni i Komisionit, se ka deklaruar si burime financimit të ardhura që nuk i ka disponuar në momentin e blerjes së tij, nuk qëndron dhe është në kundërshtim me vetë analizën që ka bërë ky organ, madje duke mos i kaluar barrë prove për këtë rrethanë/çështje.
7. Për pasurinë *apartament banimi* në Tiranë, me sip. 91.09 m², ndodhur në Rrugën e {***}, të porositur me anë të kontratës së sipërmarrjes,⁵ datë 12.05.2012, për të cilin është finalizuar blerja⁶ me kontratën e shitjes të datës 28.01.2015, subjekti kundërshton si të pabazuara dhe të padrejta konkluzionet e Komisionit se: **(i)** subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta dhe jo në përputhje me ligjin të burimeve të krijimit të kësaj pasurie, në kuptim të përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, në deklaratimet periodike vjetore; **a)** ka mungesë të deklarimit në deklaratat periodike të burimeve të përdorura për financimin e kësaj pasurie nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, lidhur me ½ pjesë takuese të pandarë të bashkëshortit në këtë apartament; **(b)** subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* si burime financimi të apartamentit, burime të ardhurash të cilat ajo dhe bashkëshorti nuk i kanë disponuar në momentin e pagesës së kësaj pasurie, duke kryer deklarim të rremë për këtë pasuri. **ii)** Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të blerë pasurinë *apartament banimi*, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për shkak të një balance negative prej 5.674.731 lekësh. **iii)** Ka kryer deklarime të rreme të burimit të krijimit të pasurisë *apartament banimi*, sipas parashikimit të germës “ç”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e vlerësimit të pasurisë, që sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me aplikimin e drejtë të ligjit dhe garantimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor

8. Subjekti pretendon se Komisioni në trajtimin e procesit së saj të rivlerësimit nuk ka zbatuar drejt ligjin dhe nuk ka argumentuar dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi:
- (i)** Komisioni nuk ka provuar se subjekti i rivlerësimit ka më shumë se 2-fishi i pasurisë së ligjshme në kuptim të përcaktimeve të nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. **(ii)** Në cilësimin e subjektit të rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm të parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni nuk ka mundur të provojë se: (a) subjekti ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5 e këtij ligji; b) nuk ka provuar se subjekti në mënyrë kumulative është në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe të pasurisë; **(iii)** jo çdo pasaktësi e

⁵ Kontrata e sipërmarrjes me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 12.05.2012.

⁶ Me kontratën e shitjes nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 28.01.2015.

konstatuar në lidhje me vlerësimin pasuror duhet të përbëjë shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, kur ato nuk janë të lidhura me indicie për korrupsion apo me veprimtari të paligjshme gjatë ushtrimit të detyrës.

9. Vendimi objekt shqyrtimi i Komisionit cenon standardet e arsytimit të vendimit, pasi:

(i) Në vendim nuk kanë gjetur reflektim shpjegimet e dhëna nga subjekti, të cilat ajo pretendon se Komisioni i ka rrëzuar duke dhënë vetëm qëndrime konkluduese të paargumentuara, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtën për të pasur një vendim të arsytuar; (ii) vendimi i Komisionit mbart mungesa të fakteve dhe ligjit apo shtrembërim të tyre, elemente të cilat lidhen me mungesën e arsytimit mbi prova; (iii) vendimi i Komisionit ka cenuar qëllimin e ligjvënësit të sanksionuar në ligjit nr. 84/2016, për largimin nga sistemi i drejtësisë të personave që janë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme e si pasojë e të cilave kanë krijuar pasuri, dhe jo personat për të cilët nuk ka asnjë indicie minimale për përfshirje në veprimtari të paligjshme.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*), për gjykimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, që ka vendosur për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Eriselda Bala, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimitimi i ankuesit

11. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma e gjyimit

12. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar në ankim që çështja e saj të gjykohej në seancë gjyqësore publike, për shkak të nevojës së shqyrtimit në themel të fakteve dhe provave, duke paraqitur dhe kërkuar për t'u administruar edhe disa prova të reja.

12.1. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur disa akte/dokumente, që kanë të bëjnë me çështje për të cilat Komisioni, me rezultatet paraprake të hetimit administrativ, nuk i ka kaluar subjektit të rivlerësimit

barrë prove, por për të cilat ka mbajtur një qëndrim penalizues në vendimin objekt shqyrtimi. Subjekti ka pretenduar në ankim se marrja e tyre në cilësinë e provës është e nevojshme për të provuar disa rrethana të rëndësishme të çështjes, që lidhen kryesisht me momentin e kryerjes së pagesës për apartamentin në pronësi të saj, si edhe për burimet e financimit për këtë pagesë⁷.

12.2. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur parashtrime⁸ në Kolegj, në zbatim të nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, të cilave, gjithashtu, iu ka bashkëngjitur një dokument me kërkesën për t'u marrë në cilësinë e provës⁹, ndërsa ka paraqitur në Kolegj një tjetër dokument të ri, më datë 06.12.2024, me anë të shërbimit postar¹⁰.

12.3. Trupi gjykues fillimisht filloi gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi, në të cilën analizoi pikë së pari pretendimet e subjektit, që lidheshin me mungesën e pretenduar të kalimit të barrës së provës për disa prej çështjeve, për të cilat më pas subjekti i është nënshtruar vlerësimit në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë, si edhe kërkesën e saj për marrjen në cilësinë e provave të reja aktet e paraqitura prej saj me ankimin, parashtrimet dhe veçmas para fillimit të seancës gjyqësore. Në vlerësim të këtyre pretendimeve, trupi gjykues arriti në konkluzionin se ishte e nevojshme që çështja të shqyrtohej në seancë gjyqësore publike me prezencën e subjektit të rivlerësimit, me qëllim konstatimin më të plotë dhe të saktë të situatës faktike, që lidhej me mënyrën e pagesës së kësteve të çmimit të apartamentit në pronësi të subjektit. Trupi gjykues vërejti se paplotësia apo paqartësia rreth kësaj situate faktike vinte si për shkak të nevojës për të adresuar çështje më specifike ndaj subjektit të rivlerësimit, lidhur me mënyrën e kryerjes së pagesave, ashtu edhe për konsiderimin në funksion të qartësimit të kësaj situate dhe të dhënave të akteve të paraqitura prej subjektit, pas dhënies së vendimit objekt shqyrtimi. Në këto akte, veçanërisht ato të paraqitura me parashtrimet, kërkesa për pushimin e procedimit penal me nr. {***} të vitit 2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe vendimi nr. {***}, datë 05.12.2024, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i cili i ka dhënë zgjidhje këtij procedimi penal, u vlerësuan prej trupit gjykues se duhej të administroheshin me cilësinë e provës, sepse jo vetëm përmbushnin testin e kriterëve të parashikuara prej nenit 47, të ligjit nr. 49/2012, duke qenë se ishin krijuar pas dhënies së vendimit të Komisionit, por edhe sepse qëndrimet e mbajtura në to, u vlerësuan me rëndësi për sa i përket konstatimit të fakteve që lidheshin me sjelljen/veprimet e subjektit dhe të bashkëshortit në pagimin e kësteve të apartamentit, në vitin 2012. Në këndvështrim të tyre, por edhe të të dhënave që jepnin aktet e tjera të paraqitura me ankimin dhe parashtrimet, trupi gjykues, në

⁷ Kontratë e Shitjes së Pasurisë së Paluajtshme nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 28.01.2015, dhe aktet bashkëlidhur saj, gjithsej 20 (njëzet) fletë, të cilat janë si vijon:

- Dëftesë postare, dërguar Eriselda Bala, për ILDKPKI-në, datë 02.06.2022, 1 (një) fletë;
- Kërkesë drejtuar ILDKPKI-së, datë 02.06.2022, 1 (një) fletë;
- Kërkesë drejtuar KPK-së, datë 30.05.2022, për vënien në dispozicion të kopjeve të akteve të fashikullit të dosjes së hetimit administrativ, 1 (një) fletë;
- Kthim përgjigje shkresës nr. {***} prot., datë 05.04.2022, dhe aktet bashkëlidhur, 20 (njëzet) fletë;
- Kontratë për shërbime ujësjellës-kanalizime nr. serial {***}, 1 (një) fletë;
- Kontratë me CEZ shpërndarje ShA;
- Kopje e librezës së pagesave të ujësjellës-kanalizimeve, 9 (nëntë) fletë;
- Deklarim periodik për vitin 2012 i babait të subjektit, B.B., dhe personave të lidhur me të, nëna dhe motrat e subjektit, printuar nga website, <https://spending.data.al/en>, (11) fletë.

⁸ Të administruara në Kolegj me nr. {***} prot., datë 02.12.2024.

⁹ Kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, së bashku me shkresën përcjellëse, prot. {***}, datë 10.01.2024, 10 (dhjetë) fletë.

¹⁰ Vendimi nr. {***}, datë 05.12.2024, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

konsideratë edhe të disa problematikave që u konstatuan lidhur me kalimin e barrës së provës¹¹, vlerësoi se debati gjyqësor mbi aktet e fashikullit të hetimit, si dhe mbi ato paraqitura rishtas, do t'i shërbenin konstatimit të saktë e të plotë të situatës faktike.

12.4. Trupi gjykues, më datë 10.12.2024, bazuar në nenin 51, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (në vijim ligji nr. 49/2012), i ndryshuar, vendosi për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, me qëllim konstatimin e saktë dhe të plotë të situatës faktike që lidhet me mënyrën e pagesës së çmimit të apartamentit në pronësi të subjektit të rivlerësimit, të ndodhur në qytetin e Tiranës. Në seancën gjyqësore të datës 13.01.2025, të caktuar në zbatim të këtij vendimi, të zhvilluar me prezencën e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues dëgjoi shpjegimet e saj rreth çështjes së identifikuar në vendimin e ndërmjetëm për kalimin në seancë gjyqësore dhe mori vendim për çeljen e hetimit gjyqësor, në zbatim të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, dhe në zbatim të neneve 45 e 49 të ligjit nr. 84/2016, për administrimin e akteve të paraqitura prej subjektit me ankimin dhe me parashtrimet para dhe gjatë seancës, në cilësinë e provës, duke ia bashkëngjitur ato fashikullit të gjykimit të çështjes.

12.5. Në përfundim të hetimit gjyqësor, trupi gjykues, shkaqet e ngritura në ankim dhe pretendimet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit i vlerësoi duke analizuar e çmuar të gjitha provat që gjendeshin në fashikullin e hetimit administrativ të krijuar nga Komisioni, si dhe ato që u administruan gjatë procesit gjyqësor.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji

i. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

13. Trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim dhe ia nënshtroi analizës shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, të cilat subjekti i rivlerësimi i ka identifikuar si arsye për të cilat duhej të vendoset ndryshimi i vendimit të Komisionit dhe konfirmimi i saj në detyrë, si vijon.

13.1. Subjekti i rivlerësimi kundërshton konkluzionin e Komisionit lidhur me automjetin tip "Mercedes Benz", vit prodhimi 2003, të blerë në vitin 2009, në shumën 11.390 euro, duke e konsideruar të padrejtë, pasi pretendon se: (i) është ngarkuar me barrë prove në tejkalim të parashikimeve ligjore në fuqi; (ii) prej saj është provuar në mënyrë të plotë se ka financuar blerjen e këtij automjeti me burime të ligjshme dhe se konkluzioni i vendimit të Komisionit, se ka deklaruar si burime financimi të ardhura që nuk i ka disponuar në momentin e blerjes se tij, nuk qëndron dhe është në kundërshtim me vetë analizën që ka bërë ky organ, duke mos i kaluar barrë prove për këtë rrethanë/çështje. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues i Kolegjit analizon sa vijon:

13.2. Komisioni lidhur me këtë pasuri, ndonëse ka konkluduar për pasjen e burimeve të ligjshme për krijimin e saj në vitin 2009, duke pranuar si të ligjshme burimet e deklaruar prej subjektit e të verifikuara prej tij, ka arritur në konkluzion rreth saktësisë së deklarimeve të subjektit për burimet e

¹¹ Ky konstatim ka të bëjë me faktin se: (i) nga Komisioni, subjektit i është kaluar barrë prove për mosdeklarimin e shpenzimeve doganore të automjetit të blerë në vitin 2009, shpenzime të cilat subjekti pretendoi se nuk kishte detyrim ligjor për t'i deklaruar; (ii) se Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove subjektit, duke konstatuar mungesën e burimeve të ligjshme të prindërve dhe të motrës se saj për t'i dhuruar dhe huazuar shumat respektivisht nga 1.000.000 lekë, të përdorura për financimin e apartamentit.

krijimit të kësaj pasurie, të lidhura si me deklarinimet në deklaratën *vetting*, ashtu edhe me ato në deklaratat periodike të vitit 2009. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka bërë deklarime të pasakta lidhur me këto burime, duke qenë se në deklaratën *vetting* ka deklaruar në mënyrë të pasaktë burimin e krijimit të automjetit objekt verifikimi me kursimet të saj gjatë viteve të studimeve në Shkollën e Magjistraturës, konkretisht të shumave 301.000 lekë dhe 5.000 USD, të depozituara në bankë, pasi depozita në shumën 5.000 USD ishte çelur përpara se subjekti të fillonte Shkollën e Magjistraturës. Ndërkohë, është fakt se të dyja shumat e deklaruar si burim për blerjen e mjetit objekt verifikimi, subjekti nuk i ka pasur në momentin e blerjes dhe zhdoganimit të mjetit, fakt për të cilin ka paraqitur shpjegimet e saj gjatë procesit të rivlerësimit. Komisioni ka vlerësuar pasaktësitë në deklarime si një sjellje e përsëritur e subjektit, e cila, ndonëse nuk ka qenë përcaktuese në marrjen e masës disiplinore, ka pasur ndikimin e saj në vlerësimin që ka bërë Komisioni për këtë kriter.

13.3. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë pasuri, duke pretenduar se:

(i) Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë, pasi në deklaratën periodike vjetore të pasurisë në vitin 2009, (në vijim “DVP”) nuk ka deklaruar pagesën e detyrimeve doganore për automjetin e blerë në atë vit, është një qëndrim në tejkalim të parashikimeve ligjore të kohës dhe, si i tillë, nuk është i drejtë dhe i bazuar ligjërisht.

(ii) Në analizën e kryer nga Komisioni për depozitën në USD, të hapur në korrik të vitit 2006, para se subjekti të fillonte Shkollën e Magjistraturës, të përdorur si burim për blerjen e automjetit, nuk është mbajtur në konsideratë fakti se deri në gusht të vitit 2012, subjekti ka jetuar me prindërit dhe ekonomia familjare ka qenë e përbashkët. Llogaria fillimisht është hapur me fondet nga kursimet e prindërve, të cilat më pas i janë lënë subjektit, meqenëse ka kontribuar në ekonominë familjare me pagën e Shkollës së Magjistraturës.

(iii) Është i padrejtë konkluzioni i Komisionit, i cili konsideron si pasaktësi mosdeklarimin në DVP-në e vitit 2009, të përdorimit të fondeve të prindërve për blerjen e automjetit, të cilat, po brenda vitit 2009 (në momentin e maturimit të depozitave), i janë kthyer atyre sërish. Në këto kushte, subjekti pretendon se si burime financimi të mirëfillta/reale të përdorura për blerjen e automjetit kanë shërbyer vlerat e kursimeve që ajo kishte në llogaritë e veta bankare, si dhe huaja e marrë nga bashkëshorti i hallës (z. V. L.), të cilat subjekti pretendon se i ka deklaruar saktësisht në deklaratën *vetting*.

13.4. Në referim të sa më sipër, trupi gjykues lidhur me këtë pasuri konstaton se Komisioni ka arritur në konkluzionin që subjekti ka bërë deklarime të pasakta në deklaratën *vetting*, por edhe në deklaratën periodike të vitit 2009, për sa i përket përcaktimit të saktë të burimeve për financimin e automjetit, si edhe deklarimin e posaçëm të vlerës së shpenzuar për zhdoganimin e tij dhe, ndonëse nuk i konsideron ato si shkak shkarkimi më vete, i vlerëson në kuadër të vlerësimit tërësor të kriterit të pasurisë. Në funksion të kontrollit të këtij qëndrimi të mbajtur në vendim, trupi gjykues analizoi pretendimet e mësipërme të subjektit të paraqitura si shkaqe në ankim, si më poshtë vijon.

13.5. Për analizimin e elementeve të mësipërme, fillimisht, trupi gjykues analizoi deklarinimet e bëra nga subjekti për automjetin në deklaratën *vetting*, si dhe në deklarinimet vjetore periodike, nga të cilat u konstatua se: **(i)** Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar se disponon: *Automjet të blerë më 07.02.2009, tip Benz C220CDI, në shumën 11.300 euro. Për blerjen e automjetit janë përdorur kursimet e mia gjatë gjithë viteve të Shkollës së Magjistraturës, konkretisht shuma prej 301.000 lekësh dhe 5.000 USD, të depozituar në bankë, si dhe një hua prej 800.000 lekësh, nga familjari V.L., shumë*

e cila është shlyer plotësisht prej meje me anë të kursimeve nga paga si prokurore; pjesa takuese 100%. (ii) Në DVP-2009, subjekti ka deklaruar se disponon: Automjet tip Benz, vit prodhimi 2003, blerë në shkurt 2009, me anë të depozitave të mia bankare 5000 USD dhe 300.000 lekë; vlera 11.300 euro; pjesa takuese 100%. Në të njëjtën rubrikë, subjekti ka deklaruar: - Depozita pranë “Intesa San Paolo Bank”, në shumën 5.000 USD, pakësuar, shuma e mbetur “zero”; - Depozitë pranë “ProCredit Bank”, në shumën 300.000 lekë, pakësuar, shuma e mbetur “zero”; - Ndërsa në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë, subjekti ka deklaruar: Detyrim në vlerën 800.000 lekë, për blerjen e makinës nga familjarë. Data e fillimit të detyrimit shkurt 2009, shlyer shuma 300.000 lekë, mbetur detyrimi për t’u shlyer në shumën 500.000 lekë. Në rubrikën e të dhënave konfidenciale, subjekti ka deklaruar “V. L., marrëveshje gojore, shkurt 2009”. (iii) Në DVP-2010, subjekti ka deklaruar: Detyrimi hua prej 500.000 lekësh, për blerjen e automjetit në pronësinë time, marrë nga V. L., shlyer shuma 500.000 lekë, mbetur për t’u shlyer “0” (zero) lekë, kam shlyer të gjithë detyrimin.

13.6. Në këndvështrim të të dhënave të referuara më sipër, trupi gjykues analizoi pretendimet e subjektit lidhur me konstatimin e Komisionit, se subjekti nuk ka deklaruar as në deklaratën vetting dhe as në DVP-2009, pagesën e detyrimeve doganore për automjetin “Mercedes Benz”. Këto pretendime u vlerësuan në raport me përcaktimet e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim ligji nr. 9049/2003), që ishin në fuqi në kohën e kryerjes së këtij deklarimi, sipas të cilave subjektet deklaruese nuk kishin detyrimin për deklarimin e shpenzimeve të kryera prej tyre brenda vitit kalendarik si një zë më vete. Me shtesat dhe ndryshimet që ky ligj pësoi, me anë të ligjit nr. 85/2012¹², është përcaktuar detyrimi i subjekteve deklaruese për të deklaruar shpenzimet që janë mbi 500.000 lekë, vlerë e cila me ndryshimet e mëpasshme të bëra me ligjin nr. 45/2014, u ul në masën 300.000 lekë. Në harmoni me këto ndryshime ligjore, është modifikuar dhe përshtatur edhe formati i deklarimit periodik, duke evidentuar në modelin e deklaratës periodike të aplikuar në vitin 2012, për detyrimin për të deklaruar shpenzimet në masën mbi 500.000 lekë dhe, më pas, në vitin 2014, detyrimin për deklarimin e shpenzimeve mbi 300.000 lekë.

Në këto kushte, në referim të legjislacionit të identifikuar për zbatim, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk kishte detyrim për të deklaruar në DVP-2009, shpenzimet e kryera gjatë këtij viti kalendarik, të cilat ishin më pak se vlera 500.000 lekë, siç rezulton të kenë qenë shpenzimet për pagesën e detyrimeve doganore të automjetit¹³.

13.7. Pavarësisht parashikimit ligjor evidentuar më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën vetting dhe në DVP-2009, duke deklaruar shumat e përdorura për krijimin e kësaj pasurie¹⁴, ka tejkaluar nëpërmjet tyre vlerën që i korrespondonte vetëm çmimit të shitjes së saj, duke ekspozuar para organeve të rivlerësimit, por edhe atyre të kontrollit të zakonshëm, ILDKPKI-së, faktin se për fitimin e kësaj pasurie ishte shpenzuar më shumë se vetëm çmimi i blerjes së saj. Në vijim të kësaj situatë rezulton se, nga kontrolli i analizës financiare të kryer nga Komisioni

¹² Në nenin 1, të ligjit nr. 85/2012, përkufizohet se “Shpenzim i deklarueshëm” është tërësia monetare e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim, si dhe të tjera shpenzime të këtij lloji të kryera nga subjekti deklarues. Në nenin 3, pika “h” e ligjit nr. 85/2012, përcaktohet detyrimi për deklarim “Të çdo shpenzimi të deklarueshëm, me vlerë 500.000 lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit”.

¹³ DPSHTR, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 22.5.2020, i ka përcjellë Komisionit dosjen e mjetit me targa {***} në pronësi të subjektit të rivlerësimit, pjesë e së cilës ishte deklarata doganore e datës 12.02.2009, sipas së cilës rezulton se subjekti ka paguar vlerën 478.502 lekë për zhdoganimin e këtij mjeti.

¹⁴ Subjekti ka deklaruar se ka shpenzuar për blerjen e saj, shumën 5.000 USD, 300.000 lekë nga kursimet e saj dhe 800.000 lekë nga huaja prej V. L.

për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit është ngarkuar me shpenzime për krijimin e kësaj pasurie, me një vlerë të përgjithshme, që përbëhet nga çmimi i blerjes prej 11.390 euro dhe nga vlera e paguar për zhdoganimin e automjetit, prej 478.502 lekë, duke kontrolluar burimet për krijimin e të gjithë shumës së përdorur për financimin e kësaj pasurie, nga e cila ka rezultuar se subjekti dhe familja e saj e origjinës¹⁵ kishin burime të ligjshme për të justifikuar pagimin e çmimit dhe shpenzimet doganore për automjetin në momentin e blerjes së tij.

13.8. Lidhur me konkluzionin e Komisionit, se subjekti ka bërë *deklarim të pasaktë që në DPV-në e vitit 2009, ku si burim për blerjen e mjetit janë deklaruar dy depozita, të cilat janë tërhequr pas blerjes dhe zhdoganimit të mjetit, pa dhënë asnjë sqarim në lidhje me burimin real të të ardhurave që kanë shërbyer në momentin e blerjes së mjetit dhe zhdoganimit të tij*, trupi gjykues konstaton dhe analizon sa vijon:

Nga deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, si dhe në DVP-2009, rezulton se në të dyja këto deklarata, burimet e financimit të automjetit janë deklaruar njësoj, duke evidentuar si të tilla: a) kursimet e subjektit në llogari bankare, në monedhat 5.000 USD dhe 300.000 lekë, për të cilat subjekti¹⁶ ka deklaruar se janë krijuar me të ardhurat e siguruara nga paga/bursa e Shkollës së Magjistraturës; b) huan e marrë nga familjari V. L. Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime, se cilat janë burimet e financimit të automjetit, meqenëse tërheqjet nga llogaritë e saj bankare, të deklaruara si burim për krijimin e kësaj pasurie, rezultojnë se janë bërë pas blerjes së automjetit¹⁷.

13.9. Në përgjigjet e dhëna për Rezultatet Paraprake të Hetimit¹⁸, të datës 30.03.2022, si dhe në ankim, subjekti ka shpjeguar lidhur me çeljen e depozitës në shumën 5.000 USD, më datë 13.07.2006, para se ajo të fillonte Shkollën e Magjistraturës. Subjekti, gjithashtu, ka evidentuar se duhet të mbahet në konsideratë se deri në gusht të vitit 2012, kur ka filluar bashkëjetesën me bashkëshortin GJ. N, ekonomia ka qenë e përbashkët me familjen e saj të origjinës, të përbërë nga prindërit dhe motrat. Lidhur me fondet e kredituara në këto llogari bankare, subjekti ka shpjeguar në Komision se llogaria bankare në USD është hapur në emër të saj në vitin 2006, përpara se babai të shkonte në një trajnim disi afatgjatë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke transferuar atje një shumë parash, që ishin kursime të prindërve, për t'i pasur në rast nevojë, gjatë mungesës së babait. Më tej, subjekti shpjegon se, nga tetori 2006 e deri në dhjetor të vitit 2009, ajo ka përfituar pagesë nga Shkolla e Magjistraturës, e cila i është dorëzuar prindërve si kontribut për të mbuluar nevojat familjare të asaj kohe, dhe se, në këmbim nga prindërit, i është lënë të disponojë shumën në llogarinë bankare të çelur në korrik 2006, me burim kursimet e tyre.

13.10. Nga të dhënat e fashikullit të hetimit administrativ rezulton se Komisioni, duke konsideruar shpjegimet e mësipërme të subjektit të rivlerësimit, ka kryer analizën e depozitave, fondet e të cilave janë përdorur për blerjen e automjetit në vitin 2009, për të verifikuar mundësinë e subjektit dhe të familjes së saj të origjinës për t'i krijuar këto fonde me burime të ligjshme. Nga analiza financiare e

¹⁵ Subjekti ka jetuar me familjen e origjinës deri në vitin 2012, në të njëjtën ekonomi me familjarët.

¹⁶ Gjatë hetimit administrativ, me përgjigjet e dhëna më datë 13.12.2021, për pyetësin nr. {***}, të Komisionit.

¹⁷ Nga të dhënat bankare rezulton se shuma 5.022 USD në "Intesa San Paolo Bank" është tërhequr më datë 24.09.2009 dhe shuma 309.597 lekë në "ProCredit Bank" është tërhequr më datë 28.03.2009.

¹⁸ Në raportin e Komisionit "Rezultate Paraprake të Hetimit Administrativ", të datës 15.03.2022, rezulton se subjektit i është kaluar barrë prove, duke konstatuar se: Duket se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, kur deklaroi kursimet gjatë viteve të studimeve në Shkollën e Magjistraturës, pasi depozita në shumën 5.000 USD është çelur më datë 13.07.2006, pra përpara se subjekti të fillonte Shkollën e Magjistraturës.

kryer si në Komision, ashtu edhe në Kolegj, rezultoi se subjekti dhe familja e saj kishin të ardhura të ligjshme për të realizuar kreditimin e fondeve në këto dy llogari bankare.

13.11. Në drejtim të analizës financiare të automjetit në Kolegj, ashtu si edhe në Komision, nuk u konsideruan mangësi lidhur me mundësinë e huadhënësit, z. V. L., për të krijuar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua subjektit, në vitin 2009, për blerjen e automjetit, hua e cila është deklaruar prej saj në DVP-2009 dhe në DVP-2010.

13.12. Në përfundim, lidhur me këto pasaktësi, trupi gjykues i Kolegjit, ndërsa ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin për sa i përket pasaktësisë në deklarimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie, që i referohet depozitave në emër të subjektit, i konsideron këto pa ndikim në vlerësimin tërësor të pasurisë, përderisa vetë Komisioni, pasi ka kryer hetimin administrativ, ka konkluduar se pavarësisht pasaktësive, subjekti kishte burime të ligjshme për ta krijuar atë. Ndërsa, lidhur me konkluzionin e Komisionit se ka pasur një deklaram të pasaktë, meqë nuk është deklaruar vlera e zhdoganimit të automjetit si shpenzim më vete, trupi gjykues vlerëson se ai nuk është i mbështetur në ligj, përderisa ligji nr. 9049/2003, në fuqi në kohën e deklarimit, viti 2009, nuk parashikonte detyrimin e subjekteve për deklarimin e shpenzimeve si një zë më vete i deklaratës. Një detyrim të tillë nuk e parashikon as ligji nr. 84/2016, për sa i përket deklarimit të dedikuar të shpenzimeve të kryera në vite. Krahas kësaj analize, trupi gjykues ka në konsideratë edhe faktin se subjekti i rivlerësimit, duke deklaruar burimet e krijimit të kësaj pasurie dhe mjetet monetare të përdorura për financimin e saj, ka sugjeruar dhe përcaktuar një shpenzim në vlerë më të lartë se vlera e përcaktuar si çmim i blerjes së saj, duke ekspozuar ndaj kontrollit çdo vlerë të shpenzuar për krijimin e pasurisë *automjet*.

14. Në vijim, trupi gjykues i Kolegjit mori në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit për pasurinë *apartamenti banimi në Tiranë, me sip. 91.09 m², në rrugën e {***}¹⁹, të cilat kundërshtojnë si të pabazuara e të padrejta konkluzionet e Komisionit se: (i) subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta dhe jo në përputhje me ligjin të burimeve të krijimit të kësaj pasurie, në kuptim të përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, në deklaramet periodike vjetore; (ii) ka mungesë të deklarimit të burimeve të përdorura për financimin e kësaj pasurie nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, lidhur me ½ pjesë takuese të pandarë të bashkëshortit në këtë apartament; (iii) subjekti ka deklaruar në deklaratën vetting si burime financimi të apartamentit burime të ardhurash, të cilat ajo dhe bashkëshorti nuk i kanë disponuar në momentin e pagesës së kësaj pasurie.*

14.1. Në vendimin e Komisionit lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 91.90 m² në Rrugën e {***} në Tiranë, është konkluduar se subjekti, përveçse ka bërë deklarime të pasakta në deklaramet periodike lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, si edhe nuk ka deklaruar pjesën dhe burimin e krijimit prej bashkëshortit të saj në DPV-2014, në të cilën ai ka bërë deklarimin fillestar të tij me statusin e bashkëjetuesit të subjektit, në analizë të disa rrethanave të cilat lidhen me momentin e pagesës së kësteve të çmimit të kësaj pasurie dhe burimeve të deklaruara se janë përdorur për to, ka rezultuar se, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të rreme lidhur me burimet e krijimit të saj si edhe gjendet në mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e saj. Në përmbledhje të konkluzioneve të lidhura me këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë, deklarimit të rremë dhe mungesës së burimeve të ligjshme, sipas parashikimeve të neni 33,

¹⁹ Për këtë pasuri, nga subjekti dhe bashkëshorti është lidhur kontrata e sipërmarrjes me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 12.05.2012; ndërsa blerja e kësaj pasurie është finalizuar me kontratën e shitjes nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 28.01.2015.

pika 5, gjerat “a”, “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, të cilat kanë çuar në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 të këtij ligji.

14.2. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit në raport me këtë konkluzion të Komisionit, sipas referimit në paragrafin 14 më sipër, duke analizuar në funksion të këtij shkaku faktet e rezultuara nga hetimi administrativ krahas atyre të rezultuara nga shqyrtimi gjyqësor në Kolegj, si elementë të rëndësishëm për të vlerësuar nëse konkluzioni i Komisioni lidhur me këtë pasuri mbështetet në një analizë të plotë dhe logjike të situatës faktike dhe nëse është marrë në zbatim të drejtë të ligjit.

14.3. Në drejtim të saktësisë së deklaramit të kësaj pasurie nga subjekti dhe personi i lidhur, trupi gjykues i Kolegjit u ndal në analizimin e deklarameve²⁰ të bëra në deklaramen vetting, si dhe të deklarameve periodike vjetore nga subjekti dhe bashkëshorti i saj për apartamentin në Tiranë, si një çështje për të cilën Komisioni ka ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.

14.4. Nga analizimi i deklarameve të subjektit dhe të bashkëshortit, trupi gjykues konstaton se, në deklaramen vetting, si dhe në deklaramet periodike për apartamentin në Tiranë, si subjekti dhe

²⁰ Në deklaramen vetting, subjekti rivlerësimit ka deklaram: Apartamenti me sip. 90m², në Rrugën e {***}, ku aktualisht banoj, i blerë në shumën 48.000 euro, me anë të kontratës së shitjes nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 28.01.2016, e regjistruar pranë ZRVP Tiranë me nr. pasurie {***}, në bashkëpronësi me bashkëshortin GJ. N. Për blerje e këtij apartamenti janë përdorur: - 1.000.000 lekë, dhuratë nga gjyshërit e mi, Z. B., e H. B., me anë të kontratës së dhurimit nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 25.11.2011, shumë e tërhequr nga llogaria e hapur prej tyre më 19.01.2006, pranë Bankës së Shqipërisë; - 1.000.000 lekë, dhuratë nga prindërit e mi, B. B., e V. B., shumë e tërhequr nga llogaria e nënës V.B., llogari e hapur në datën 13.07.2006, pranë Bankës “ProCredit”; - 1.000.000 lekë, hua nga motra ime E.B., shumë e tërhequr nga llogaria e saj pranë “Union Bank”, shumë ende e pashlyer nga ana ime. - Diferenca 400.000 lekë, kursime nga paga ime si prokurore; pjesa takuese: 50%.

- Në deklaramen vetting, bashkëshorti i subjektit ka deklaram: Apartamenti me sip. 90m², në Rrugën e {***}, ku aktualisht banoj, i blerë në shumën 48.000 euro, me anë të kontratës së shitjes nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 28.01.2016, e regjistruar pranë ZRVP Tiranë me nr. pasurie {***}, në bashkëpronësi me bashkëshortin Eriselda Bala. Për blerje e këtij apartamenti janë përdorur këto burime: - Dhuratë nga prindërit e mi, B., dhe SH. N., 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë, të tërhequra nga depozitat e tyre bankare, nga kursimet e tyre në vite, të depozituara në “Raiffeisen Bank”; - 400 USD të tërhequra nga llogaria ime personale, nr. {***}, në “Raiffeisen Bank”; - 500.000 leke të patura në cash nga kursimet nga paga/dieta/shpërblime, të kursyera në vite nga paga si oficer i Policisë Gjyqësore prej vitit 2002 e në vijim. Pjesa takuese: 50%.
- Në DVP-2011, subjekti rivlerësimit deklaron: Dhuratë nga gjyshërit e mi, me kontratën e dhurimit nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 25.11.2011, shuma 1.000.000 lekë, pjesa takuese 100%.
- Në DVP-2012, subjekti rivlerësimit deklaron: Lidhur kontratë sipërmarrje për apartamentin, vlera 48.000 euro, paguar deri tani 47.000 euro. Në bashkëpronësi me z. GJ. N. Po në këtë deklaram, subjekti deklaron 1.000.000 lekë hua motrës sime E. B., për kontratën e sipërmarrjes, vlera e paguar “0”, detyrimi i mbetur 1.000.000 lekë dhe 1.000.000 lekë dhuratë nga prindërit për blerje apartamenti. Në DVP- 2012, bashkëjetuesi i subjektit nuk bën asnjë deklaram.
- Në DVP -2014, bashkëshorti i subjektit, GJ. N., deklaron: Kontratë sipërmarrje nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 12.05.2012, për porositjen e një apartamenti me sip. 91.9 m², në Rrugën e {***}, me vlerë 48.000 euro; pjesa takuese 50 %; Depozitë bankare pranë “Raiffeisen Bank”, e krijuar në bazë të kursimeve nga të ardhurat vjetore, shuma 11.075 USD, pjesa takuese 100%; 300.000 lekë gjendje në cash, prej të cilave 100.000 dhuratë nga nëna ime SH.N., 150.00 lekë borxh i shlyer nga shtetasi A. T., dhe 50.000, të kursyera gjatë vitit 2014.
- Në DVP-2015, subjekti në rubrikën e ndryshimit të pasurive deklaron: Apartamenti në bashkëpronësi me bashkëshortin/bashkëjetuesin GJ. N., me kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 12.05.2012, i deklaram dhe në deklaramet e mëparshme, është paguar kësti i fundit prej 1000 eurosh dhe është lidhur kontrata e shitjes. Bashkëlidhur, kopje e certifikatës së pronësisë. Paguar 1000 euro; pjesa takuese 50%. Gjendje në llogarinë rrjedhëse pranë “Raiffeisen Bank”, më datë 31.12.2012, është (-) 12.732 lekë (shumë e tërhequr nga overdraft); Huaja e marrë nga motra sime E. B., prej 1.000.000 lekë, e pashlyer ende.
- Në DVP- 2016, subjekti, në vijim të deklarameve të bëra në DVP-2015 dhe D-Vetting, sërish në rubrikën e detyrimeve financiare deklaron: Hua prej 1.000.000 lekësh, marrë motrës sime E.B., me qëllim blerje apartamenti, shlyer “0” lekë, mbetur për t’u shlyer/detyrim 1.000.000 lekë.

bashkëshorti kanë deklaruar burimet për pjesët e tyre takuese në masën 50%, të vlerës së apartamentit në Tiranë, duke e përshkruar fitimin e pronësisë dhe burimet e krijimit kësaj pasurie si me një kontribut të përbashkët në pjesë të barabarta. Në këto kushte, edhe kontrolli i deklarimeve respektive dhe burimeve është bërë po ashtu nga Komisioni, në mënyrë të veçantë për secilin bashkëshort.

14.5. Problematika e parë e evidentuar prej Komisionit, lidhur me deklaratimet e bëra nga bashkëshorti i subjektit, për apartamentin në Tiranë, i përket faktit se, në deklaratën periodike të vitit 2012, kur është deklaruar për herë të parë pasuria objekt verifikimi dhe pagesat e kryera, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të pjesës takuese të bashkëshortit (bashkëjetuesit në atë kohë). Ndërsa, bashkëshorti i subjektit nuk e kishte deklaruar burimin e krijimit të pjesës së tij takuese në deklaratën periodike të vitit 2014, deklarimi i parë i tij për shkak të bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit. Edhe në deklarimin periodik të pasurisë për vitin 2015, bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për pjesën e tij takuese në çmimin e blerjes së pasurisë, por ka deklaruar vetëm burimin e krijimit të kështit të fundit, të pretenduar prej 1.000 eurosh, për shkak të pakësimit të gjendjes *cash* prej 300.000 lekësh. Pra, bashkëshorti i subjektit e ka deklaruar për herë të parë këtë burim në deklaratën *vetting*. Komisioni e ka konsideruar këtë rrethanë si një pasaktësi në deklaram dhe e ka kualifikuar atë si në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

14.6. Në funksion të analizës së kësaj çështje, trupi gjykues mori në shqyrtim deklaratimet e bashkëshortit të subjektit në deklaratën *vetting*, deklarimet periodike dhe parashikimet e ligjit të zbatueshëm në kohën e kryerjes së secilit prej këtyre deklarimeve, nga të cilat rezultuan të dhënat si vijon:

Në deklaratën *vetting*, si burim financimi për apartamentin, personi i lidhur ka deklaruar shumën 6.600 euro, si dhe 1.100.000 lekë, dhuratë nga prindërit, të tërhequra nga llogaritë e kursimeve të tyre, si edhe kontributin e tij personal në vlerën prej 400 USD, të tërhequra nga llogaria ime personale nr. {***}, në “Raiffeisen Bank”; - 500.000 lekë të disponuara në *cash* nga kursimet nga paga/dieta/shpërblime, të kursyera në vite nga paga si oficer i Policisë Gjyqësore prej vitit 2002 e në vijim. Në DVP- 2012, viti i krijimit të pasurisë, z. GJ. N., asokohe bashkëjetuesi i subjektit, nuk ka bërë asnjë deklaram për pasurinë *apartment* në Tiranë, pasuri për të cilën ai, për herë të parë, e ka deklaruar në DVP-2014.

14.7. Në kuadër të këtyre deklarimeve, trupi gjykues konstaton njësoj si Komisioni se, as bashkëshorti i subjektit dhe as subjekti nuk kanë deklaruar në DPV-në e vitit 2012, vit në të cilin është krijuar pasuria dhe paguar pothuaj plotësisht çmimi i saj [përveç vlerës prej 1000 eurosh të paguara në vitin 2014], lidhur me të drejtat e personit të lidhur në këto deklarata, as për sa i përket pjesës së tij takuese dhe, për pasojë, as për burimet e krijimit të përdorura për këtë pjesë. Pavarësisht se kjo situatë nënkuptohet, për shkak të rrethanave që janë pasqyruar se kanë ndodhur më pas, rezulton se në këtë vit, deklarimi i subjektit është kufizuar në deklarimin e pjesës së saj dhe burimeve të përdorura prej saj për krijimin e pasurisë, me arsyetimin se personi i lidhur qëndronte me subjektin në atë kohë, në kushtet e një bashkëjetese fakti të paformalizuar ende në martesë ligjore, dhe në mungesë të parashikimeve ligjore që detyronin subjektet deklaruese të bënin deklarime për persona me këtë status.

14.8. Ndërsa konsiderohet e provuar kjo situatë faktike, duke qenë se subjekti ka lidhur martesën ligjore me personin e lidhur në datën 15.06.2015, trupi gjykues mori në analizë legjislacionin e

zbatueshëm për të përcaktuar nëse subjekti i rivlerësimit kishte ose jo detyrimin për deklarim të këtyre fakteve. Nga kjo analizë rezulton se, vetëm me ndryshimet ligjore të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” të ndryshuar (në vijim ligji nr. 9049/2003), të bëra me nenin 21, të ligjit nr. 45/2014, u përcaktua detyrimi për deklarimin e pasurisë jo vetëm për bashkëshortin dhe fëmijët madhorë të subjektit deklarues, *por edhe për bashkëjetuesin*, siç paraqitet situata në rastin konkret. Pas këtij ndryshimi, siç është evidentuar më sipër, rezulton se bashkëjetuesi i subjektit, GJ.N., ka plotësuar DVP-2014, e cila është dorëzuar në mars të vitit 2015. Nga deklaratet e bëra prej tij në këtë vit konstatohet se janë evidentuar vetëm veprimet financiare të kryera gjatë vitit 2014 lidhur me pasurinë në fjalë dhe nuk janë deklaruar burimet e përdorura për financimin e pjesës së tij takuese të apartamentit, të cilat ishin përdorur në vitin 2012, koha e pagimit të pjesës më të madhe të çmimit, që janë deklaruar rishtas në deklaratën *vetting*.

14.9. Nga leximi i DPV-2014, rezulton se, ndonëse ajo është plotësuar rishtas prej personit të lidhur, ajo nuk ka në përmbajtje rubrikat e një deklarate që i përket një deklarimi fillestar, siç ishte rasti i deklarimit, por është plotësuar sipas modelit të deklarimit periodik, duke plotësuar rubrikat përkatëse që përcaktonin deklarimin e ndryshimeve në pasuri nga viti i mëparshëm kalendarik. Në këto kushte, personi i lidhur ka deklaruar pjesën takuese në pasurinë *apartament*, objekt kontrolli të fituar sipas kontratës së sipërmarrjes së vitit 2012, pa deklaruar burimet e krijimit të saj. Në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se, ndonëse vetë modeli i formularit nuk jepte qartësi për mënyrën se si duhej të deklaroheshin pasuritë rishtas prej bashkëjetuesve, për shkak të ndryshimeve ligjore, sërish titullimi i rubrikave përkatëse, sugjeronte për deklarimin e pasurive dhe të burimeve të tyre. Për pasojë vlerësohet se, ndonëse nën një lloj ambiguiteti, personi i lidhur, për sa kohë që ka deklaruar të drejtat e pronësisë mbi apartamentin, duhej të kishte deklaruar edhe burimet e krijimit të tij, ndonëse ishin përdorur në një vit të mëparshëm deklarimi, në vitin 2012, në të cilin personi i lidhur nuk kishte detyrim për deklarim. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i personit të lidhur në DPV-2014, nuk ka qenë i plotë, për sa kohë që ka lënë pa deklaruar burimet e krijimit të pjesës së tij takuese. Pavarësisht kësaj anomalie në deklarim rezulton se personi i lidhur ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë burimet e përdorura për krijimin e pasurisë në deklaratën *vetting*, duke mundësuar organet e rivlerësimit të verifikojnë deklaratet e tij lidhur me këto burime dhe duke lënë pa peshë përcaktuese pasaktësitë e konstatuara në DPV-2014.

14.10. Në referim të sa evidentuar më lart, trupi gjykues, pasi analizoi konkluzionet e mësipërme në funksion të shkaqeve të ankimit, arriti në përfundimin se mungesa e deklarimit prej bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të burimeve të financimit të pjesës së tij në këtë pasuri, në deklaratën periodike të vitit 2014, në të cilën për shkak të statusit si bashkëjetues dhe ndryshimeve të ligjit nr. 9049/2003, ai kishte rishtas detyrimin për deklarim, ndonëse është një konstatim i saktë për sa i përket rrethanave të faktit, nuk mund të kualifikohet si një deklarim i pasaktë, për sa kohë që i referohet pasaktësisë në deklaratën periodike të pasurisë, e cila është korrigjuar me deklarimin e plotë të këtyre burimeve në deklaratën *vetting*.

14.11. Në vijim, trupi gjykues, për apartamentin në Tiranë, mori në analizë pretendimet e subjektit, me të cilat ajo kundërshton si të pabazuara dhe jo të drejta, konkluzionet e Komisionit se: *subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të blerë pasurinë apartament banimi, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016*, duke arsyetuar si vijon:

14.12. Nga vendimi i Komisionit konstatohet se konkluzioni që subjekti gjendet në mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, është arritur duke marrë qëndrime për dy çështje të ndërvarrura njëra me tjetrën. *Së pari*, Komisioni ka analizuar mënyrën/kohën e pagesës së çmimit të apartamentit dhe, duke arritur në konkluzionin se kjo pagesë nuk është bërë në mënyrën e deklaruar e të shpjeguar prej subjektit, në një fazë të dytë të analizës, janë analizuar burimet e deklaruar se janë përdorur për pagesat e kësteve të apartamentit, si në momentin e pranuar prej Komisionit, ashtu edhe në momentin e deklaruar prej subjektit, dhe në të dyja versionet, Komisioni ka gjetur problematika me provueshmërinë e këtyre burimeve, duke arritur në konkluzionin se ato nuk kanë qenë të mjaftueshme në kohën e kryerjes së pagesave për të justifikuar krijimin e pasurisë. Trupi gjykues mori në analizë shkaqet e ankimit lidhur me këtë konkluzion, duke ndjekur të njëjtën logjikë, në funksion të përcaktimit, *së pari* të kohës së kryerjes së pagesave dhe *së dyti*, të kontrollit të burimeve të përdorura për kryerjen e tyre.

14.13. Në funksion të analizimit të momentit të pagesës së kësteve të apartamentit, prej hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për apartamentin në Tiranë, kanë rezultuar të dhënat si vijon:

i. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë nënshkruar, në cilësinë e porositësve, me shoqërinë “{***}” ShPK, si sipërmarrës, kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 12.05.2012, për pasurinë *apartament* me sip. 91.09 m², në Rrugën e “{***}”, Tiranë.

Në këtë kontratë është përcaktuar se pagesat për blerjen e këtij apartamenti do të bëhen si vijon:

- Kësti i parë, në shumën 8.000 (tetë mijë) euro, do të likuidohet menjëherë me firmosjen e kësaj kontrate, siç është rënë dakord mes palëve.
- Kësti i dytë, në shumën 39.000 euro, do të likuidohet në momentin e dorëzimit të çelësave, me përfundimin e plotë të ndërtesës (brenda muajit qershor 2012).
- Kësti i tretë, në shumën 1.000 euro, do të likuidohet me nënshkrimin e kontratës së shitjes së apartamentit.

ii. Gjatë hetimit, subjekti ka sqaruar²¹ se likuidimet e kësaj pasurie janë kryer si vijon:

- 8.000 euro, në datën e nënshkrimit të kontratës së porosisë, datë 12.05.2012.
- 39.000 euro më datë 23.07.2012, sipas mandatarkëtimit.
- 1.000 euro më datë 05.01.2015, sipas mandatarkëtimit.

iii. Nga korrespondenca e Komisionit me DPPP²² dhe BKT²³, rezultoi se kishte raportime për dy transaksione të kryera nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht dy depozitime në *cash*, në vlerat 33.150 euro dhe 14.850 euro, për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK, në datën 08.06.2012.

iv. Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime²⁴ mbi kryerjen e këtyre dy transaksioneve përpara pagesës së kësteve sipas mandatarkëtimeve, si dhe të deklaronte vlerën reale të këtij apartamenti. Subjekti, në përgjigjet e dhëna Komisionit, i ka qëndruar vlerës së çmimit të përcaktuar në kontratë, prej 48.000 eurosh, duke deklaruar përsëri të njëjtat data pagese dhe duke ridepozituar dy mandatarkëtimet, për pagesat në *cash*, të bëra pranë shoqërisë “{***}” ShPK.

²¹ Pyetësor nr. {***}, datë 06.12.2021.

²² Shkresë nr. {***} prot., datë 14.05.2020.

²³ Shkresë nr. {***} prot., datë 12.05.2020 dhe shkresë nr. {***} prot., datë 20.01.2022.

²⁴ Pyetësor nr. {***}, datë 24.01.2022.

14.14. Subjekti i rivlerësimit, si gjatë hetimit administrativ në Komision, ashtu edhe me ankimin, ka kundërshtuar si tërësisht të padrejtë dhe jo në përputhje me të vërtetën e saj jetësore, konsiderimin e pagesës së apartamentit në Tiranë nëpërmjet dy mandatpagesave bankare të realizuara në emër të saj, në dy sportele të ndryshme të degëve të Bankës BKT në Tiranë, më datë 08.06.2012. Nga aktet e hetimit administrativ konstatohet se, fillimisht, subjekti i rivlerësimit është njohur për ekzistencën e dy mandatpagesave bankare të datës 08.06.2012, me pyetjet e drejtuara nga Komisioni, me anë të pyetësorit nr. {***}, me anë të të cilit i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime mbi kryerjen e këtyre dy transaksioneve bankare. Subjekti, në përgjigje të këtij pyetësi, i ka shpjeguar Komisionit se: *“Në lidhje me ekzistencën e këtyre dy mandateve jam vënë në dijeni vetëm më datë 24.01.2022, me anë të email-it tuaj bashkëlidhur pyetësorit të {***}. E vënë në dijeni në lidhje me ekzistencën e këtyre dy mandateve, menjëherë kam kërkuar informacion pranë BKT-së, ku i vetmi informacion që më është dhënë, ka qenë fakti se këto pagesa të këtyre mandateve janë kryer në dy degë të ndryshme të BKT-së, konkretisht një nga mandatet i përket degës së BKT “{***}” dhe tjetra në degën e BKT Rruga e {***}, të dyja këto veprime të kryera në datën 08.06.2012. E bindur se ky veprim nuk është kryer nga ana ime dhe e bindur për falsitetin e tyre, kam kërkuar kryerjen e ekspertimit grafik të nënshkrimeve të mandateve të vëna në dispozicion nga ana juaj [...].*

14.15. Sipas aktit të ekspertimit grafik nr. {***}, datë 28.01.2022, të kryer nga eksperti i licencuar V.H., dhe dorëzuar në Komision prej subjektit, është arritur në konkluzionin se nënshkrimet në aktet e nënshtruar ekzaminimit grafik: *“Nuk janë shkruar nga asnjëri prej dy shtetasve: Eriselda Bala apo GJ. N. Dy ‘Firmat’ që shoqërojnë dy shkrimet me përmbajtje ‘Eriselda Bala’, në dy dokumentet objekt i këtij ekspertimi, janë dukshëm produkte grafike të imitimeve dhe sajimeve grafike”.*

14.16. Po ashtu, subjekti, për të bindur Komisionin se vlera e apartamentit që ajo disponon është 48.000 euro, ashtu siç është parashikuar në kontratën e sipërmarrjes dhe të shitjes, i ka paraqitur këtij organi kopje të kontratave të fqinjëve të saj, të cilët kanë blerë sipërfaqe të përafërt me të, kundrejt një shumë të përafërt me atë të shpenzuar nga subjekti.

14.17. Komisioni, pasi është njohur me shpjegimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit nr. {***}, si dhe ka administruar aktin e ekspertimit grafik të dorëzuar prej saj, ka vijuar hetimin me marrjen në pyetje të përfaqësueses së shoqërisë “{***}” ShPK. Nga deklaratimet e përfaqësueses së shoqërisë, znj. L. H., pyetur nga Komisioni në datën 02.03.2022, në mënyrë të përmblodhur rezultoi se: **(i)** shoqëria është bërë me dije nga klienti, subjekti i rivlerësimit, që nuk e kishte të mundur që ta kryente pagesën në muajin qershor 2012, sipas parashikimit të kontratës së sipërmarrjes, dhe likuidimin do ta bënte më vonë; **(ii)** në kushte të tilla ishin injektuar/përdorur fonde të shoqërisë nga dividendi i administratorit, në vlerën 48.000 euro, të derdhura në llogaritë bankare të shoqërisë në BKT, si të kryera në emër të subjektit, për nevoja të shoqërisë për lëvizjen e likuiditeteve; **(iii)** dokumenti i identifikimit në bankë i përkiste subjektit të rivlerësimit; **(iv)** sipas një marrëveshjeje me bankën, ka ndodhur që pagesat e çmimit të blerjes së pasurive të bëheshin nga një punonjës i shoqërisë, duke përdorur kartën ID të klientit blerës.

14.18. Pas kryerjes së hetimit administrativ dhe konsiderimit edhe të shpjegimeve të subjektit në përgjigje të barrë së provës,²⁵ për t'i dhënë zgjidhje çështjes, Komisioni përdori kryesisht qëndrimet si vijon:

- i) PAGESA E APARTAMENTIT nuk është kryer sipas kësteve që pretendon subjekti, por është bërë me dy pagesa bankare të realizuara më datë 08.06.2012, fakt i provuar nga dy transfertat bankare të kryera pranë bankës BKT, në favor të shoqërisë së ndërtimit, me pagesë të evidentuar Eriselda Bala, në këtë datë.
- ii) PAGESA bankare ka qenë kusht kontraktor i kontratës së sipërmarrjes.
- iii) Subjekti i rivlerësimi nuk është personi që ka realizuar pagesat bankare në bankën BKT, më datë 08.06.2012, por ajo duhet të ketë autorizuar realizimin e tyre.
- iv) Mandatpagesat e depozituara nga subjekti, me të cilat kërkohet të provojë kryerjen e pagesës totale në shumën 39.000 euro, më datë 23.07.2012, dhe 1.000 euro, më 05.01.2015, nuk janë mandatarkëtime të mirëfillta, por vërtetime të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit.
- v) Në 23 korrik të vitit 2012, kur subjekti pretendon se janë paguar në *cash* 39.000 euro për apartamentin në Tiranë, ajo nuk dispononte shumat e parave që pretendon se ka përfituar si dhurim nga prindërit dhe motra e saj.
- vi) Deklarimet e përfaqësueses së shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK, nuk janë bindëse dhe të besueshme për Komisionin.
- vii) Subjekti është i pabesueshëm në kallëzimin që ka bërë ndaj Bankës BKT për falsifikimin e mandateve, ndërsa nuk ka nisur të njëjtin aksion ligjor ndaj shoqërisë së ndërtimit, që duket se është arsyeja kryesore e falsifikimit dhe dëmtuesja e interesave të saj.

Mbështetur në këto argumente, Komisioni e ka konsideruar të pabesueshëm deklarin e subjektit, se pagesat për shlyerjen e çmimit të apartamentit janë bërë në datën 23.07.2012 dhe konkludoi se: [...] Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni krijoi bindjen se çmimi i blerjes së pasurisë apartament banimi me nr. {***}, prej 48.000 euro, është likuiduar në datën 6.8.2012 (ndonëse transfertat bankare janë kryer nga një punonjës i shoqërisë “{***}” ShPK), dhe jo sipas pretendimeve të subjektit, se 8.000 euro janë paguar në datën e lidhjes së kontratës së porosisë, datë 12.5.2012, 39.000 euro më 23.7.2012 dhe 1.000 euro më 5.1.2015, fakt që afekton analizën financiare përfundimtare të kryer me qëllim vërtetimin e blerjes së pasurisë me të ardhura të ligjshme²⁶...

14.19. Në kundërshtim të konkluzionit të Komisionit, lidhur me momentin e pagesës së çmimit të apartamentit në Tiranë, subjekti, në ankim ashtu edhe në parashtimet e paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, pretendon se vijon:

- i) Apartamenti në Tiranë është porositur nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 12.05.2012, me çmimin e përcaktuar 48.000 euro. PAGESA E APARTAMENTIT është kryer me këste, sipas përcaktimeve të kontratës së sipërmarrjes: përkatësisht 8.000 euro janë paguar në datën e lidhjes së kontratës së porosisë, datë 12.05.2012, shuma 39.000 euro

²⁵ Në rezultatet e hetimit, Komisioni i kishte kaluar subjektit barrë prove për të provuar të kundërtën e konkluzionit se çmimi i apartamentit ishte sa totali i pagesave të kryera nëpërmjet transfertave bankare dhe atyre sipas mandatarkëtimeve të paraqitura prej saj.

²⁶ Për këtë çështje eidentojmë se vetë Komisioni, fillimisht, analizën për burimet e financimit të apartamentit e ka kryer duke konsideruar si moment të realizmit të pagesës së apartamentit datën 23.07.2012.

më 23.07.2012 dhe 1.000 euro më 05.01.2015, para lidhjes së kontratës së shitjes nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 28.01.2015, pagesa këto të provuara me mandatpagesa të kryera në *cash*, pranë shoqërisë së ndërtimit.

- ii) Pagesat janë kryer duke u bazuar në specifikimet e kontratës së sipërmarrjes.
- iii) Nuk ka kryer asnjë pagesë bankare për këtë apartament dhe nuk ka autorizuar kryerjen e pagesave të tilla nga shoqëria e ndërtimit. Pagesat e kryera nëpërmjet Bankës BKT, më datë 08.06.2012, nuk janë të autorizuar nga subjekti dhe bashkëshorti i saj.
- iv) Subjekti ka marrë në dorëzim çelësat e apartamentit më datë 24.07.2012, që vijon direkt pas datës së kryerjes së pagesës së kështit të dytë, prej 39.000 eurosh.
- v) Burimet e financimit të këtij apartamentit janë të ligjshme dhe ato janë të deklaruar prej subjektit dhe bashkëshortit në deklaraten *vetting* e të shpjeguara gjatë procesit të rivlerësimit.

14.20. Në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, gjatë seancës gjyqësore publike, të zhvilluar më datë 13.01.2025, subjekti, lidhur me momentin e pagesës së çmimit të apartamentit, saktësimi i të cilit ishte edhe shkaku i kalimit të çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, ndër të tjera, kërkoi nga trupi gjykues të merret në cilësinë e provës vendimi nr. {***}, datë 05.12.2024, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, i cili ka zgjidhur me vendim të formës së prerë procedimin penal të regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, mbi kallëzimin e subjektit të rivlerësimit. Sipas këtij vendimi, Gjykata e Apelit ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit Elbasan dhe pushimin e çështjes penale për procedimin penal nr. {***}, të vitit 2022, për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve” dhe “Shpërdorim detyre”, parashikuar respektivisht nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal. Gjithashtu, Gjykata ka disponuar edhe *Deklarimin e falsitetit të dokumenteve: (a) “Mandat arkëtimi” i Bankës Kombëtare Tregtare, datë 18.06.2012, Dega {***}, vlera 14.850 euro; (b) “Ekstrat print” i Bankës Kombëtare Tregtare, datë 08.06.2012, ora 11:35, vlera 14.850 euro; (c) “Mandat arkëtimi” i Bankës Kombëtare Tregtare, datë 08.06.2012, Dega {***}, vlera 33.150 euro; (d) “Ekstrakt print” i Bankës Kombëtare Tregtare, datë 08.06.2012, ora 15:58, vlera 33.150 euro; si dhe asgjësimi i tyre.*

14.21. Në funksion të zgjidhjes së këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, pasi analizoi të dhënat që kanë rezultuar nga hetimi administrativ dhe ai gjyqësor, arriti në disa konsiderata të rëndësishme, të cilat u vlerësuan relevante për arritjen e një konkluzioni lidhur më të dhe që do të arsyetohen si vijon.

14.22. Në këtë drejtim, trupi gjykues konstatoi se, edhe pse Komisioni ka pranuar si të vërtetë pretendimin e subjektit se dy mandatpagesat e bankës BKT, të datës 08.06.2012, nuk janë nënshkruar nga subjekti, në konsideratë të aktekspertimit grafik nr. {***}, datë 28.01.2021, si dhe dëshmisë së përfaqësueses së shoqërisë “{***}” ShPK, ka arritur në konkluzionin se pagesa është realizuar në Bankë nga përfaqësues të kësaj shoqërie, mbi bazën e dhënies së një autorizimit për pagesë nga subjekti. Në vendim, Komisioni mbështet qëndrimin për ekzistencën e një autorizimi nga subjekti, duke iu referuar rrethanave të faktit, si edhe kërkesave të nenit 4/1, pika 1 e ligjit²⁷ nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (në vijim ligji nr. 9917/2008), të cilat duket se diktojnë një të tillë në rastin e kryerjes së transaksioneve të këtij lloji.

²⁷ Shih: https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Ligj_per_parandalimin_e_pastrimit_te_parave-1.pdf

14.23. Në analizë të këtij qëndrimi të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se ligji nr. 9917/2008, deri në vitin 2012, ka pësuar vetëm dy shtesa dhe ndryshime, përkatësisht me ligjin nr. 10391, datë 03.03.2011 dhe me ligjin nr. 66/2012, datë 07.06.2012. Nga përmbajtja e integruar e ligjit nr. 9917/2008, e publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave, evidentohet se pikërisht neni 4/1, që referon në vendim Komisioni, është dispozitë që është shtuar si pjesë e këtij ligji me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 66/2012, datë 07.06.2012, të publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 80, të datës 13.07.2012. Në këtë kuptim vlen të sillen në vëmendje se ligji i zbatueshëm është identifikuar në mënyrë të gabuar prej Komisionit, pasi në momentin e realizimit të pagesës në Bankën BKT, më datë 08.06.2012, neni 4/1²⁸ i ligjit nr. 9917/2008, nuk kishte hyrë ende në fuqi, pasi nuk ishte publikuar në Fletoren Zyrtare. Nga përmbajtja e ligjit nr. 9917/2008, të aplikuar deri në qershor të vitit 2012, rezulton se rregulli që duhej zbatuar në rastin konkret ishte neni 5 i ligjit, emërtuar “Dokumentacioni i kërkuar për identifikimin e klientit”²⁹.

14.24. Përmbajtja e kësaj dispozite ligjore përcakton rregullin që duhej të zbatonte Banka BKT në rastin konkret, për të lejuar kryerjen me autorizim të një veprimi në emër të një klienti, sipas të cilit, në funksion të realizimit të dy pagesave bankare të datës 08.06.2012, të përshkruar si “*derdhje në llogari të O., nga Eriselda Bala*”, më së paku duhet të kishte kopje origjinale apo të noterizuara të autorizimit për realizimin e kësaj pagese nga persona të tretë, së bashku me kopje të noterizuar të kartës së identitetit të autorizuesit, në këtë rast të subjektit.

Në këtë kuptim, trupi gjykues sjell në vëmendje se: (i) subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e saj ka theksuar se derdhjet në Bankën BKT, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK janë bërë me paraqitjen e kopjes së kartës së saj të identitetit, e cila i ishte dorëzuar shoqërisë si pjesë e kontratës së sipërmarrjes; (ii) ndërsa Komisioni, në analizën e tij, nuk ka mundur të evidentojë ndonjë akt (*email, dokument të shkruar etj.*), i cili mund të ketë shërbyer si autorizim i dhënë nga subjekti për punonjësit e kompanisë së ndërtimit për realizimin e këtyre pagesave në emër të saj. Në thelb, trupi gjykues çmon se referimi i Komisionit në këtë bazë ligjore është i gabuar, jo vetëm për shkak se dispozita e identifikuar si e zbatueshme ende nuk kishte hyrë në fuqi, por edhe të faktit se situata faktike nuk sugjeron rregullimin e saj nëpërmjet zbatimit të këtij ligji, pasi rregullat e tij do të ishin në veprim, në

²⁸ Neni 4/1 i shtuar në ligjin nr. 9917/2008 me ligjin nr. 66/2012, parashikon:
Neni 4/1, “Masat e vigjilencës së duhur” (shtuar me ligjin nr. 66/2012, datë 07.06.2012).

1. Në kuadrin e ushtrimit të vigjilencës së duhur ndaj klientit, subjektet duhet:

a) Të identifikojnë klientin (të përhershëm apo rastësor, person fizik, juridik apo organizime ligjore) dhe të verifikojnë identitetin e tij nëpërmjet dokumenteve, të dhënave apo informacioneve të marra nga burime të besueshme dhe të pavarura.

b) Për klientët që janë persona juridikë ose organizimet ligjore:

i) të verifikojnë nëse çdo person që vepron në emër të klientit të tij është i autorizuar dhe të identifikojnë dhe të verifikojnë identitetin e tij;

ii) të verifikojnë statusin e tyre ligjor, nëpërmjet dokumenteve të themelimit, të regjistrimit ose fakteve të ngjashme të ekzistencës së tyre, si dhe të sigurojnë informacion për emrin e klientit, emrat e të mirëbesuarve (për organizimet ligjore), formën ligjore, adresën, drejtuesit dhe/ose përfaqësuesit ligjorë (për personat juridikë) dhe dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet juridike.

²⁹ Në pikën 2 dhe 3 të kësaj dispozite përcaktohet se: [...]

2. Subjektet (si të tilla ligji identifikon ndër të tjera Bankat) pranojnë nga klienti për të marrë të dhëna për të, sipas përcaktimeve të këtij neni, vetëm dokumente origjinale ose fotokopje të noterizuara. Për qëllime të këtij ligji, subjekti mban në dosjen e klientit kopje të vulosura me vulën e subjektit, të dokumenteve të paraqitura nga klienti në formën e mësipërme, brenda afatit të vlefshmërisë së tyre.

3. Subjektet, kur e gjykojnë të nevojshme, duhet të kërkojnë paraqitjen nga klienti të dokumenteve të tjera identifikuese për verifikimin e të dhënave të paraqitura prej këtij të fundit.

rast se punonjësit e bankës do të kishin kryer derdhje të shumave në emër të subjektit, por të realizuara prej tyre. Ndërsa, konkretisht në rastin në analizë, janë kryer derdhjet, sikur ato po realizoheshin drejtpërdrejt prej subjektit, të pasqyruara këto veprime në akte të provuara, edhe nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të cituar më lart, se kanë qenë të falsifikuara dhe nuk janë nënshkruar prej saj dhe as nga personi i lidhur. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se referimi tek kjo dispozitë për zgjidhjen e çështjes është i gabuar dhe se arritja në një konkluzion për zgjidhjen e saj, duhet të jetë produkt i analizës së rrethanave të faktit, që kanë rezultuar prej hetimit administrativ edhe atij gjyqësor, mbështetur në përcaktimin e vlerës provuese të secilës prej provave të administruara sipas çmuarjes së trupit gjykues, mbështetur edhe në bindjen e brendshme, në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

14.25. Si pjesë e arsyetimit të mësipërm, fillimisht, trupi gjykues u ndal në analizimin e sjelljes së subjektit pas marrjes dijeni, se në emër të saj ishin realizuar dy mandatpagesa bankare, më datë 08.06.2012, për pagesën e apartamentit, duke qenë se Komisioni e ka konsideruar atë si pjesë të vlerësimit që e ka çuar në konkluzionin se subjekti është i pabesueshëm në shpjegimet e saj. Komisioni, me pyetësin nr. {***}, të datës 24.01.2022, i ka bërë me dije subjektit për ekzistencën e këtyre pagesave bankare dhe, pas këtij momenti, subjekti ka kryer një sërë veprimesh, si reagim për marrjen dijeni të këtij fakti, përkatësisht: **(i)** Në datën 25.01.2022, subjekti ka kërkuar informacion pranë Bankës BKT, lidhur me pagesat e kryera në emër të saj, më datë 08.06.2012. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Banka BKT, me shkresën nr. {***} prot., datë 25.01.2022, i bën me dije subjektit të rivlerësimit se pagesa me shumën 33.150 euro është kryer në Degën e BKT-së në Rrugën e {***}, më datë 08.06.2012, ora 15:27 dhe se veprimi për pagesën e shumës 14.850 euro është kryer në Degën e BKT-së, në rrugën “{***}”, më datë 08.06.2012, ora 11:31. **(ii)** Subjekti ka kërkuar kryerjen e ekspertimit grafik të nënshkrimeve të mandateve, nga i cili, sipas aktit të ekspertimit grafik nr. {***}, datë 28.01.2022, është konkluduar se nënshkrimet në këto dy mandatpagesa nuk janë realizuar nga subjekti dhe as nga bashkëshorti i saj. **(iii)** Pasi ka marrë dijeni për konkluzionet e akteksptimit, së bashku me përgjigjen e mësipërme të Bankës BKT, ia ka bashkëlidhur ato përgjigjeve të saj për pyetësin nr. {***}, të përcjella në Komision më datë 28.01.2022. **(iv)** Më datë 31.01.2022 ka depozituar kallëzimin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, lidhur me dy pagesa të bëra nëpërmjet bankës BKT, në emër të saj, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, duke pretenduar se pagesa prej saj dhe bashkëshortit si blerës janë bërë me pagesë në *cash*, në ambientet e shoqërisë ndërtuese dhe kurrsesi nëpërmjet sistemit bankar, duke ngritur dyshime se nënshkrimet në këto akte në emër të saj janë të falsifikuara në bashkëpunim midis punonjësve të shoqërisë dhe punonjësve të bankës. Mbi bazën e këtij kallëzimi, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, datë 15.02.2022, për veprat penale “Falsifikim i dokumenteve” dhe “Shpërdorim detyrë”, të parashikuara nga nenet 186/3 dhe 248 të Kodit Penal, ndaj Bankës Kombëtare Tregtare. Ky procedim penal është pushuar më pas, bazuar në kërkesën e Prokurorisë, sipas së cilës, pasi është provuar falsiteti i akteve të prodhuara nga Banka BKT, ka qenë e pamundur të ushtrohej më tej ndjekja penale për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit sipas nenit 66 të Kodit Penal, fakt që rezulton nga përmbajtja e vendimit nr. {***}, datë 05.01.2024, e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të marrë në cilësinë e provës në këtë gjykim.

14.26. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se të gjitha veprimet e kryera nga subjekti, menjëherë pas marrjes dijeni për ekzistencën e dy pagesave bankare në emër të saj, nëpërmjet të cilave janë transferuar fonde në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, flasin së pari për një

reagim të natyrshëm, të menjëhershëm dhe të arsyeshëm të një individi që merr dijeni rishtas për ngjarjen, si dhe për zgjedhjen e rrugës së duhur ligjore për të goditur aktet dhe thirrjen në përgjegjësi të personave përgjegjës dhe, së dyti, tregojnë përpjekjet për të evidentuar pavërtetësinë e këtyre veprimeve bankare në funksion të peshës që këto akte do të kishin në procesin e saj të rivlerësimit. Arsytimi i Komisionit, se subjekti duket se ka kallëzuar penalisht vetëm veprimtarinë e zhvilluar prej punonjësve të Bankës dhe jo të shoqërisë, gjendet nga trupi gjykues i pambështetur. Subjekti rezulton të ketë kallëzuar në organet e ndjekjes penale, faktin penal, si edhe rrethanat në të cilat ai është kryer. Kjo mënyrë e të ekspozuarit të çështjes nuk shmang asnjë veprim hetimor të Prokurorisë drejt rrethit të personave përgjegjës sipas kompetencës së saj për të zhvilluar hetimin. Hetimet e kryera mbi këtë çështje nuk mund të ishin atribut i subjektit dhe as të ndikoheshin prej saj, përkundrazi, adresimi i problematikës tek organi i akuzës konsiderohet si një element që dëshmon se subjekti nuk ka hezitur t'i nënshtrohet për këtë çështje një kontrolli të detajuar e të thelluar në kontekstin e një procedimi penal.

14.27. Më pas, trupi gjykues mori në analizë konstatimet e Komisionit sipas të cilave: *krijohet bindja se realisht nuk ka pasur një marrëveshje midis palëve për shtyrjen e afatit të pagimit të kështit me vlerë 39.000 euro dhe se shuma prej 48.000 eurosh është paguar nga një punonjës i shoqërisë “{***}” ShPK., në datën 08.06.2012, pasi ishte parapaguar nga subjekti i rivlerësimit. Ky qëndrim i Komisionit bazohet në të dhëna si: (i) Përcaktimet e kontratës së shitjes së pasurisë apartament me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 26.01.2015, e cila parashikon se çmimi i kontratës në shumën 48.000 euro është likuiduar nga ana e blerësit në favor të shitësit, në llogarinë bankare të këtij të fundit, dhe nuk përmend pagesat e realizuara me dy shkresat mandatarkëtime të sipërcituara; (ii) Mangësitë në formatin e mandatarkëtimeve në cash të kryera nga subjekti dhe bashkëshorti pranë shoqërisë “{***}” ShPK, të cilat nuk i konsideron si mandatarkëtime të mirëfillta me numër serie dhe në formatin e njohur të tyre, por i konsideron si dy shkresa të printuara dhe të nënshkruara nga shoqëria, në datat 23.07.2012 dhe 05.01.2015.*

14.28. Subjekti i rivlerësimit, me ankimin, si dhe me parashtrimet e paraqitura në Kolegj, kundërshton konstatimet e mësipërme të Komisionit si të pavërteta dhe evidenton se kontrata e shitjes së apartamentit në Tiranë, e depozituar në praktikën që ASHK-ja ka përcjellë në Komision, përcakton se pagesa e kësaj pasurie është bërë sipas përcaktimeve të kontratës së sipërmarrjes, tek e cila është përcaktuar pagesa me tri këste.

14.29. Lidhur me qëndrimet e mësipërme, si dhe me pretendimet e subjektit, se Komisioni nuk i referohet përmbajtjes së kontratës përfundimtare të depozituar pranë ZRVPP (sot ASHK), e cila i është përcjellë zyrtarisht Komisionit gjatë hetimit administrativ, por i referohet përmbajtjes së një drafti të vjetër kontrate, të dhënë gabimisht nga noteri, konstatohet se subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ ka paraqitur në Komision, si dhe në Kolegj, bashkëlidhur ankimit, shkresën e datës 07.06.2022, në të cilën notere M. SH., shpjegon se kontrata e përfundimtare e shitjes është ajo që është e depozituar në ASHK, e cila përcakton pagimin e vlerës së apartamentit sipas kontratës së sipërmarrjes³⁰.

³⁰ Në kontratën e sipërmarrjes përcaktohet se:

Shlyerja e çmimit të blerjes do të bëhet nga Porositësi sipas kushteve:

a) Kësti I, në shumën 8.000 euro, do të likuidohet menjëherë me firmosjen e kësaj kontrate.

b) Kësti II, në shumën 39.000 euro, do të likuidohet në momentin e dorëzimit të çelësave, me përfundimin e plotë të ndërtesës.

Ndërkohë, edhe në praktikën e administruar në fashikullin e hetimit administrativ, gjendet përkatësisht shkresa e përcjellë në Komision nga ASHK, Dega Tirana Veri, me nr. {***} prot., datë 08.09.2020, me të cilën është përcjellë kontrata e shitjes së apartamentit me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 26.01.2015, në të cilën përcaktohet se: “*Vlera e apartamentit është likuiduar nga blerësit në favor të shitësit sipas kontratës së sipërmarrjes*”. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se informacioni që ofron kontrata e shitjes së apartamentit, e cila është përcjellë në Komision nga ASHK-ja dhe figuron e regjistruar në regjistrat publikë, është dokumenti me vlerë të plotë provuese në raport me të tretët dhe që konsiderohet se ofron të dhënat më të sakta për modalitetet e pagesës së apartamentit, mbi të cilin duhet mbështetur analiza e mëtejshme e çështjes, ndonëse kjo e dhënë nuk vlerësohet se është përcaktuese në krijimin e bindjes për faktet që po analizohen në çështjen objekt gjykimi.

14.30. Në të njëjtin drejtim vlerësohet edhe informacioni që ofron kontrata e sipërmarrjes e lidhur në vitin 2012, sipas të cilës përcaktohet se pagesa do të shlyhet në numrin e llogarisë {***}, të shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK, në Bankën “Societe Generale Albania”. Në kushtet kur nuk ka asnjë të dhënë që tregon për përdorimin e kësaj llogarie, si një rrugë për kryerjen e pagesave, pasi ato edhe në versionin që pranon Komisioni janë kryer brenda një dite në sportelet e Bankës BKT, konsiderimi prej Komisionit si përcaktues i mënyrës së pagesës sipas parashikimit të kontratës së sipërmarrjes, nuk duket se vjen si konkluzion i një analize të plotë të rrethanave të faktit. Me fjalë të tjera, derisa kontrata ka përcaktuar se pagesat duhen bërë në llogarinë e identifikuar në të, çdo mënyrë tjetër do të duhej të konsiderohej e pabesueshme, qoftë edhe pagesa në një bankë të ndryshme nga ajo që përcakton vetë kontrata. Rrethanat e faktit tregojnë se palët kanë shmangur përcaktimet kontraktuale për mënyrën e pagesës dhe, për pasojë, analiza e asaj që ka ndodhur dhe pasqyrohet në aktet e tjera, të ndryshme nga kontrata e sipërmarrjes, duhet vlerësuar në mënyrë harmonike në raport me çdo të dhënë që rezulton nga hetimi, për të arritur në një konkluzionin të drejtë.

14.31. Krahas analizës së mësipërme, e cila në thelb përmban elemente që godasin arsyetimin e Komisionit drejt besueshmërisë së subjektit për fakte që, pavarësisht se janë rrethanore, duket se kanë pasur peshë në krijimin e bindjes së shumicës së trupit gjykues të Komisionit, trupi gjykues shqyrtoi në drejtim të krijimit të bindjes së tij për kalendarin e pagesave, informacionin që ofrojnë dy aktet e emërtuara “mandatarkëtime”, të datës 23.07.2012, me vlerën 39.000 euro dhe të datës 15.01.2015, në vlerën 1.000 euro. Këto akte janë paraqitur nga subjekti për të provuar deklaratimet e saj se pagesat e kryera për apartamentin nuk janë sipas asaj që pasqyrojnë mandatpagesat bankare të provuara si të falsifikuara nga hetimi penal, por sipas kalendarit të pasqyruar në këto mandatarkëtime të lëshuara nga shoqëria “{***}” ShPK dhe të nënshkruara prej subjektit e personit të lidhur. Ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti, Komisioni ka mbajtur qëndrim se ato nuk kanë vlerë provuese, për sa kohë *ato nuk janë mandatarkëtime të mirëfillta, por vërtetime të hartuara përgjatë procesit të rivlerësimit*.

14.32. Lidhur me këtë element të analizës së Komisionit, trupi gjykues evidenton disa të dhëna, që shërbejnë për të vlerësuar konkluzionin e Komisionit, por edhe vlerën provuese të këtyre akteve, si:

(i) Në aktin e emërtuar “Mandat arkëtimi”, të datës 23.07.2012, i cili ka në pjesën hyrëse të tij të dhënat e shoqërisë që e ka lëshuar, si: “{***}” ShPK, me NIPT {***}, adresën dhe nr. e telefonit,

c) *Kësti III, në shumën 1.000 euro, do të likuidohet me nënshkrimin e kontratës së shitjes së apartamentit, të përshkruar më sipër.*
*Pagesa do të shlyhet në numrin e llogarisë {***}, të shoqërisë “{***}” ShPK, në Bankën “Societe Generale Albania”.*

pasqyrohet se: Sot më 23 korrik, znj. Eriselda Bala (GJ.N.) kreu pranë zyrës së “{***}” ShPK likuidimin përfundimtar të detyrimit në vlerën 39.000 euro, sipas kontratës së sipërmarrjes. Vlera 1.000 euro do të likuidohet në momentin e marrjes së hipotekës. Ky akt është i nënshkruar nga arkëtarja e shoqërisë, S.C., nga subjekti i rivlerësimit Eriselda Bala dhe z. GJ.N. **(ii)** Nga pikëpamja e formës duket se ky akt nuk është sipas një formati mandatarkëtimi të miratuar me ndonjë akt nënligjor, të përdorur në fushën e veprimeve financiare prej shoqërive tregtare, të hasur në raste të tjera. Ndërkohë, në përmbajtjen e tij, ky akt ka të gjitha elementet që përmban një mandatarkëtim, duke evidentuar përkatësisht: (a) entitetin e personit juridik që e ka lëshuar, në këtë rast shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK; (b) palën paguese, përkatësisht subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesi GJ.N.; (c) vlerën e paguar më datë 23.07.2012 në shumën 39.000 euro; (d) nënshkrimin e personit që ka arkëtuar shumën dhe të personave që e kanë paguar atë. E njëjta situatë, për sa i përket formës, paraqitet edhe në mandatarkëtimin e datës 05.01.2015. **(iii)** Konfirmimin e përmbajtjes së këtyre mandatpagesave nga deklaratimet e përfaqësueses së shoqërisë “{***}” ShPK, e cila ka dëshmuar në Komision se shoqëria kishte parapaguar për nevoja të administrimit të aktivitetit të saj tregtar, shumat përkatëse në llogaritë bankare në Bankën BKT, në emër të subjektit, dhe kjo e fundit ka paguar detyrimin e saj në arkën e shoqërisë në datën e pasqyruar në mandatarkëtimet. Deklarimet e përfaqësueses së shoqërisë “{***}” ShPK, të marra nga Komisioni në zbatim të nenit 49, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, rezultojnë të jenë prova të marra nga burime të njohura e të identifikuar, të cilat duhen vlerësuar si burim për provimin e fakteve për të cilat ato japin të dhëna, në këndvështrim të pikës 4 të po këtij neni. **(iv)** Me provat e reja të sjella prej subjektit dhe të administruara në procesin gjyqësor në Kolegj, u paraqit edhe një vërtetim i lëshuar prej QKB-së, nga i cili rezultonte se specimenti i vulës së shoqërisë, në vitin 2019, ishte krejt i ndryshëm nga ai i përdorur prej saj në vitin 2012, në mandatarkëtimet objekt analize. Ky element tregon se, më së paku, këto akte nuk janë krijuar gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, i cili për subjektin ka filluar në datën 23.12.2019, duke lënë pa peshë konkluzionin e Komisionit se mandatarkëtimet e këtij formati janë krijuar gjatë procesit dhe për llogari të tij. **(v)** Rezulton se subjekti i ka paraqitur këto mandatarkëtime në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, të drejtuar nga Komisioni në datën 28.01.2022, kohë në të cilën subjekti, në versionin e një skenari të krijuar enkas për llogari të procesit, mund të kishte fabrikuar mandatarkëtime me data më të favorshme për të, siç mund të ishte nëntori i vitit 2012, të cilat i shmangnin asaj problematikën që do të trajtohet në vijim, lidhur me burimet e krijimit të pasurisë të deklaruar, të cilat nuk disponoheshin në kohën e kryerjes së pagesave prej prindërve dhe motrës së saj. Fabrikimi i një versioni kaq të vesuar e me defekte, duket se përgënjeshtrohet vetë fabrikimin sipas një analize logjike që i përshtatet profilit të subjektit si një magjistrate/prokurore në detyrë. **(vi)** Fakti që subjekti ka paraqitur vetëm dy mandatarkëtime, të cilat provojnë pagesën e shumës prej 40.000 eurosh, sipas edhe deklaratimeve të kryera në DPV-të e viteve 2012 dhe 2015, pa tentuar të krijojë një mandat të ri arkëtimi për shumën fillestare të paguar sipas kontratës së sipërmarrjes, në ditën e nënshkrimit të së saj, datë 12.05.2012, në shumën prej 8.000 eurosh, ndonëse Komisioni ka këmbëngulur në qëndrimin se subjekti nuk e ka paguar këtë shumë në këtë ditë, sepse ajo nuk paraqet për pagimin e saj asnjë dokument. Subjekti ka vijuar të qëndrojë koherente në shpjegimet e saj, se shuma fillestare është paguar ditën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes dhe se për provimin e këtij fakti nuk është përpiluar asnjë dokument tjetër, për sa vetë kontrata përmban një parashikim të tillë.

14.33. Në analizë të kësaj shtate faktike, trupi gjykues arriti në konkluzionin se defektet në elementet e formës lidhur me këto akte, balancohen nga të dhënat e mësipërme, që të çojnë drejt një analize

harmonike për vlerën provuese të tyre, në kuptim të neneve 45 e 49 të ligjit nr. 84/2016, e cila nuk zhbëhet në vlerësimin e gjykatës, për shkak të mangësive të formës, të kompensuara me elemente të përmbajtjes apo me indicie të tjera, që dëshmojnë për një realitet të ndryshëm nga ai që ka konkluduar Komisioni.

14.34. Në vijim të analizës, trupi gjykues mori në shqyrtim të dhënat e tjera që rezultojnë nga përmbajtja e akteve të administruara gjatë hetimit administrativ të Komisionit, lidhur me pagesën e apartamentit në Tiranë, të cilat vlerësohen se i japin besueshmëri pretendimeve të subjektit, se pagesat janë kryer sipas shpjegimeve të saj dhe atyre që pasqyrojnë mandatarkëtimet e lëshuara prej shoqërisë “{***}” ShPK, përkatësisht:

- i. Në DVP-2012, rezulton se subjekti ka deklaruar se ka lidhur kontratë sipërmarrje për blerje apartamenti me vlerë 48.000 euro, nga të cilat janë paguar 47.000 euro, dhe në DVP-2015 ka deklaruar se është paguar kësti i fundit me vlerë 1.000 euro. Këto deklarime të kryera në deklaratat periodike, të cilat në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mund të përdoren si provë në procesin e rivlerësimit kalimtar, referojnë të dhëna që përputhen me shpjegimet e subjektit për pagesën e apartamentit me tri këste, si dhe me përmbajtjen e kontratës së sipërmarrjes dhe mandatarkëtimeve, kalendar i cili përjashtohet nga versioni që ka pranuar Komisioni, se pagesa e apartamentit është bërë me një pagesë të vetme, më datë 08.06.2012.
- ii. Gjithashtu, konstatohet se pranimi prej Komisionit i likuidimit të gjithë vlerës së apartamentit, nëpërmjet dy pagesave të kryera në sportelet e bankës BKT, më datë 08.06.2012, vjen në kundërshtim me parashikimin kontraktor, se pagesa e kështit të parë, prej 8.000 eurosh, do të bëhej menjëherë me nënshkrimin e saj, duke përcjellë një qëndrim jokohorent edhe prej vetë Komisionit lidhur me detyrueshmërinë e zbatimit të parashikimeve kontraktuale. Komisioni, ndërsa i referohet kontratës për mënyrat e pagesës në llogarinë bankare, nuk i referohet asaj për kohën e pagimit të kështit të parë, sipas pikës 4.1, germa “a”, që për më tepër konfirmohet edhe nga palët.
- iii. Rezulton se nga shoqëria “{***}” ShPK, subjektit dhe bashkëshortit të saj i janë dorëzuar çelësat e apartamentit sipas procesverbalit të datës 24.07.2012, i cili daton një ditë pas realizimit të pagesës në *cash*, të kështit në shumën 39.000 euro. Në kontratën e sipërmarrjes, në pikën 4.1, germa “b”, parashikohet se: *kësti i dytë, në shumën 39.000 euro, do të likuidohet në momentin e dorëzimit të çelësave, me përfundimin e plotë të ndërtesës (brenda muajit qershor)*. Rendi kronologjik i kryerjes së veprimeve, pagimi i kështit në datën 23.07.2012, sipas mandatit të arkëtimit, dhe dorëzimi i çelësave në datën 24.07.2012, sipas procesverbalit përkatës, duket se vijnë në përputhje me rendin e parashikuar në kontratën e sipërmarrjes. Përcaktimi se përfundimi i ndërtesës duhet të ishte brenda muajit qershor, duket se është një moment që parashikohet se do ndodhte, por për shkak të natyrës së realizimit të tij, ky moment edhe mund të mos ndodhë sipas parashikimit, pasi duket se më shumë se një detyrim kontraktor, ai shfaqet si një orientim për kohën e kryerjes së veprimeve mes palëve, të cilat detyrimisht duhet të ndodhin sipas rendit të përcaktuar në kontratë. Pra, në analizën që i bëhet këtij përcaktimi, duket se rendi i veprimeve është një detyrim kontraktor, *përfundim ndërtese, pagim kësti, dorëzim çelësash*, ndërsa koha ekzakte se kur këto veprime do të kryhen, mbetet orientuese.

iv. Po ashtu, nga të dhënat e fashikullit të Komisionit rezulton se konsumi i energjisë elektrike në këtë apartamenti ka nisur në gusht³¹ të vitit 2012, bazuar në kontratën e lidhur nga bashkëshorti i subjektit si konsumator familjar “Për shërbime ujësjellës kanalizime”, me UKT Tiranë, më datë 25.07.2012, fakte të cilat duken si një indicie drejt provueshmërisë së marrjes së tij në dorëzim në kohën e pretenduar prej subjektit.

14.35. Krahas analizës së mësipërme, trupi gjykues shqyrtoi edhe të dhënat e lëvizjeve të llogarisë bankare në Bankën BKT të shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK, tek e cila është derdhur në emër të subjektit të rivlerësimit vlera 48.000 euro, për periudhën qershor – dhjetor 2012, në funksion të besueshmërisë së deklarimeve të përfaqësueses së shoqërisë, dhënë para Komisionit, se derdhja e kësaj shume në emër të subjektit, para se ajo ta paguante realisht atë, është kryer nga punonjës të shoqërisë për nevoja të administrimit financiar të saj, nga e cila rezulton se:

i. Në datën 08.06.2012, llogaria e shoqërisë është çelur me gjendje banke vetëm prej 599.55 eurosh dhe më pas ka vijuar me dy depozitime (kreditime) në *cash*, njëra prej të cilave është në emër të subjektit, prej 14.850 eurosh, dhe tjetra në emër të një blerësi tjetër, në shumën 15.150 euro. Të dyja kreditimet së bashku bëjnë shumën 30.000 euro. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë bankare, rezulton se veprimi i radhës i menjëhershëm, i kryer nga kjo llogari bankare e shoqërisë është një likuidim (debitim) në shumën 30.000 euro, i realizuar në favor të një furnitori, me përshkrimin “*shlyerje detyrimi viti 2012*”. Këto transaksione tregojnë që shumat e depozituara në mëngjesin e datës 8 qershor, menjëherë, brenda së njëjtës ditë, janë përdorur nga shoqëria për shlyerje detyrimi, që tregon nevojën e shoqërisë për pasje likuiditetesh për të shlyer detyrime financiare të saj.

ii. Në vijim, po në datën 08.06.2012, në të njëjtën llogari të shoqërisë “{***}” ShPK, rezulton të jenë kryer dy depozitime të tjera, njëra prej të cilave në emër të subjektit të rivlerësimit, në shumën 33.150 euro dhe tjetra prej një blerësi tjetër, prej 40.350 eurosh. Pas marrjes së pagesës së dytë, që figuron në emër të subjektit, më datë 8 qershor (ditë e premte), nga llogaria nuk janë bërë veprime të tjera dhe llogaria bankare e shoqërisë është mbyllur me gjendjen 74.899.55 euro. Ditën e hënë, më datë 11.06.2012, nga ana e shoqërisë janë kryer 4 transaksione për shlyerje detyrimesh, fakt që përsëri tregon për nevojën e shoqërisë për likuiditete në funksion të shlyerjes së detyrimeve të saj.

iii. Gjatë intervalit kohor 11 – 13 qershor 2012 (nga e hëna në të mërkurë), në llogarinë në monedhën euro të shoqërisë “{***}” ShPK është kredituar në total shuma prej 172.700 euro dhe është debituar për shlyerje detyrimesh shuma prej 162.480 eurosh. Gjendja e llogarive të shoqërisë, më datë 13 qershor, rezulton në shumën 10.220.35 euro dhe 1.913.110 lekë, veprime të cilat dëshmojnë se shoqëria i ka përdorur kreditimet e marra në funksion të shlyerjes së detyrimeve të saj mujore ndaj furnitorëve apo kontraktorëve të ndryshëm. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare të shoqërisë (për periudhën qershor – dhjetor), vërehet që llogaritë e saj, përgjithësisht, kreditohen me likuiditet në fillim të muajit, rreth datave 6 – 11 dhe më pas vijohet me shlyerje detyrimesh. Kjo situatë konstatohet përgjithësisht në të gjithë muajt që përmban akti i deklarimit të lëvizjeve bankare i lëshuar nga BKT, që do të thotë se shoqëria ka si praktikë shlyerjen e detyrimeve rreth datave 11 – 13 të çdo muaji, përpara deklarimit të librave të shitjes dhe të blerjes së TVSH-së, që kryhet më datë 14 të çdo muaji. Mënyra se si është vepruar në muajin qershor, tregon që shumat e kredituara në llogari, vërtet janë përdorur nga shoqëria për shlyerje detyrimi dhe nuk kanë qëndruar pasive dhe të

³¹ Pasi për periudhën nga lidhja e energjisë elektrike në këtë apartament, që është bërë nga shoqëria “{***}” ShPK, e deri në gusht 2012, rezulton se nga furnizuesi i energjisë eklektike (CEZ) janë faturuar vlera te vogla (rreth 340 lekë), që përfaqësojnë tarifat mujore të mirëmbajtjes së rrjetit.

papërdorura, element që, në njëfarë mënyre, justifikon shpjegimet e dhëna nga përfaqësuesja e shoqërisë pranë Komisionit gjatë periudhës së hetimit administrativ.

14.36. Në përfundim të të gjithë arsyetimit të mësipërm, për sa i përket konkluzionit se subjekti ka bërë deklarime të pasakta në deklaratën *vetting*, të burimeve të krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues analizoi të gjitha faktet që kanë rezultuar nga hetimi administrativ dhe gjyqësor, të cilat shërbejnë për konstatimin e saktë të situatës faktike, që lidhet me mënyrën e pagimit të çmimit të apartamentit, për të cilin Komisioni ka konkluduar se është kryer në datën 08.06.2012, sipas mandatpagesave të lëshuara nga Banka Kombëtare Tregtare. Në përfundim të analizës së kryer, trupi gjykues arriti në përfundimin se konkluzioni i mësipërm i Komisionit nuk mbështetet në prova të mjaftueshme dhe logjika e përdorur për t'i dhënë kuptim veprimit të kryer nga shoqëria “{***}” ShPK, sikur është paraprirë nga një pagesë e subjektit të rivlerësimit të këtyre shumave, është e pambështetur nga të dhënat e tjera të rezultuara nga hetimi.

14.37. Konkluzioni i mësipërm mbështetet në mënyrë sintetike në faktet të vlerësuara se janë provuar në proces, si vijon:

- (i) Faktin e pranuar edhe prej Komisionit, por edhe nga hetimi penal, se nënshkrimet në mandatpagesat e lëshuara nga Banka BKT, të shumës prej 48.000 eurosh, në datën 08.06.2012, nuk janë nënshkruar prej subjektit të rivlerësimit dhe se ato nënshkrime janë të falsifikuara;
- (ii) Paraqitjen prej subjektit të rivlerësimit të një kallëzimi penal lidhur me këtë fakt, menjëherë sapo është vënë në dijeni;
- (iii) Mosevidentimin e ndonjë veprimi apo sjelljeje të drejtpërdrejtë të subjektit apo personit të lidhur, që tregon për bazueshmërinë e logjikës së përdorur prej Komisionit, se këto shuma janë parapaguar prej saj në arkën e shoqërisë;
- (iv) Paraqitjen prej subjektit të dy mandatarkëtimeve, të datave 23.07.2012 dhe 15.01.2015, që dokumentojnë pagesën e shumave, respektivisht 39.000 euro dhe 1.000 euro, pranë shoqërisë “{***}” ShPK në këto data;
- (v) Deklarimin në deklaratat periodike vjetore të pasurisë të viteve 2012 dhe 2015, të pagesave si më sipër;
- (vi) Dorëzimin e apartamentit sipas procesverbalit të datës 24.07.2012, një ditë pas pagesës së shumës principale të çmimit prej 39.000 eurosh;
- (vii) Lidhjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike në datën 25.07.2012, menjëherë pas dorëzimit të apartamentit;
- (viii) Pagimin e vlerës prej 8.000 eurosh në datën 12.05.2012, që i përket ditës së lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, sipas përcaktimeve të kësaj kontrate dhe në mungesë të çdo të dhëne tjetër që evidenton të kundërtën;
- (ix) Konstatimin në lëvizjet bankare të shoqërisë “{***}” ShPK, të lëvizjes së shumave monetare të derdhura në emër të subjektit, menjëherë, për llogari të furnitorëve të shoqërisë, duke i dhënë një shpjegim në këtë mënyrë nevojës së shoqërisë për likuiditet, sipas deklarimeve që ka bërë edhe përfaqësuesja e saj gjatë hetimit në Komision.

14.38. Për sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit nuk është i mbështetur në prova dhe se subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë, se janë parapaguar me fonde të saj shumat e përcaktuara në mandatpagesat e lëshuara nga Banka BKT. Sipas këtij arsyetimi, trupi gjykues e gjeti të pamjaftueshëm dyshimin që duket se shoqëron të gjithë linjën logjike të arsyetimit të vendimit të Komisionit, rreth motiveve të shoqërisë së ndërtimit për derdhjen paraprakisht në bankë të shumave të parave në emër të subjektit, madje duke falsifikuar nënshkrimin e saj, për të mbështetur qëndrimin e tij, përderisa të gjitha faktet e renditura më lart, por jo vetëm, duket se shkojnë në dobësimin e këtij dyshimi, i cili mbetet një element i pambështetur në fakte, e për pasojë nuk mund të krijojë një konsekuencë negative për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

15. *Trupi gjykues, në mbështetje të konkluzionit të mësipërm rreth pavërtetësisë së mandatpagesave të realizuara në bankë, të datës 08.06.2012, mori në analizë burimet e deklaruara prej subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie, sipas deklaratës vetting, për të cilat Komisioni ka konkluduar se nuk janë krijuar me të ardhura të ligjshme, pasi nuk disponoheshin prej subjektit në momentin e përdorimit të tyre, duke analizuar sa vijon.*

15.1. Komisioni ka analizuar veçmas burimet e krijimit të pasurisë, sipas deklarimeve të subjektit dhe personit të lidhur, duke i verifikuar respektivisht ato për pjesën takuese të secilit, si në versionin që këstet janë paguar sipas mandatpagesave të bankës, në të cilin pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme është evidente dhe për të nuk ka pasur ndonjë analizë të dedikuar, pasi as subjekti nuk ka deklarime për disponimin e fondeve në këtë moment, me arsyetimin se nuk është ai momenti i pagesës sipas analizës së të bërë më lart. Në analizën e bërë në versionin se pagesat janë kryer në momentin e pretenduar prej subjektit, Komisioni për burimet e financimit të pjesës takuese të subjektit të rivlerësimit³² ka konkluduar se: *në momentin e pagesës së pretenduar në datën 23.7.2012, të shumës 39.000 euro, subjekti nuk i ka pasur shumat e dhuruara dhe dhënë hua, përkatësisht nga prindërit dhe motra e saj, në vlerën prej 1.000.000 lekësh/secila palë.* Komisioni ka mbështetur konkluzionin e tij mbi të dhënat e llogarive bankare të nënës dhe të motrës së subjektit, të cilat provohet se janë tërhequr menjëherë pas maturimit të tyre, në tetor dhe nëntor të vitit 2012, dhe nuk janë disponuar prej titullarëve të tyre në korrik 2012, kohë në të cilën subjekti pretendon se janë kryer pagesat.

15.2. Së pari, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove lidhur me gjetjen, se në 23 korrik të vitit 2012, ajo nuk dispononte shumat e pretenduara si të dhuruara nga prindërit e të marrë hua nga motra e saj, duke evidentuar për pasojë se ky është një konkluzion për të cilin ajo nuk ka dhënë shpjegime.

15.3. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues, nga leximi i raportit “Rezultate paraprake të hetimit administrativ” konstaton se, lidhur me burimet e financimit të apartamentit për pjesën takuese të subjektit, është analizuar sa vijon:

- ***Për shumën 1.000.000 lekë, të dhuruar nga prindërit, B. B. dhe V. B.: Në analizë të rrethanave të sipërcituara, si dhe faktit që Komisioni deri aktualisht nuk ka rënë në dijeni të ndonjë kundërshtie për këto marrëdhënie të krijuara midis palëve, si marrëdhënie të posaçme familjare,***

³² Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit, për apartamentin në Tiranë, ka deklaruar se vlera e tij është 48.000 euro, nga e cila pjesa e saj takuese është 50%.

por edhe të mospasjes të ndonjë konflikti të mundshëm interesi³³ të subjektit dhe bashkëshortit³⁴ të saj me shtetasin V. L., për shkak të funksionit të saj, duket bindës deklarimi i subjektit për marrjen e kësaj huamarrje të përkohshme (3-4 mujore) nga prindërit e saj deri në maturimin e depozitave të prindërve dhe motrës.

○ **Për shumën 1.000.000 lekë, hua nga motra E. B.:**

Komisioni kreu hetimin e tij dhe i rezultoi se të ardhurat nga punësimi për motrën e subjektit, E. B., për periudhën qershor 2010 – dhjetor 2011, janë në vlerën 1.642.918 lekë. Kjo shumë është më se e mjaftueshme për të mbuluar huan e dhënë. Komisioni nuk i ka përfshirë shpenzimet e jetesës, pasi në analizën e kryer për prindërit e subjektit, i ka përllogaritur aty për të gjithë familjen. Motra e subjektit, pagën e saj e merr pranë “Union Bank”,³⁵ dhe po në këtë bankë i ka edhe kursimet e saj, të investuara në depozitë. Shumën e dhënë hua ndaj subjektit, ajo e ka tërhequr më datë 09.11.2012. Për shkak se kjo tërheqje daton pas pagesës së këstit të dytë të apartamentit, Komisioni e ka pyetur subjektin³⁶ dhe, në përgjigjen e dhënë, ka konfirmuar të njëjtën situatë të rezultuar edhe për dhurimin e prindërve, të cilën Komisioni e ka trajtuar më sipër.

15.4. Siç evidentohet më sipër, nga leximi i rezultateve të hetimit, rezulton se pretendimi i subjektit për moskalim barrë prove për këto gjetje, të cilat më pas i janë ngarkuar subjektit, si një prej shkaqeve për të cilat është vendosur masa disiplinore, duket i drejtë. Në përpjekje për të kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, krahas provave të paraqitura gjatë hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës së re, në mungesë të kalimit të barrës së provës, deklaratën periodike të bërë nga babai i saj, si subjekt deklarues në vitin 2012, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, si dhe deklaratimet që kanë bërë nëna dhe motra e subjektit, si persona të lidhur me të atin. Trupi gjykues e administroi si provë këtë akt, në të cilin familjarë të subjektit kanë bërë deklaratimet si vijon:

i. Babai i subjektit, z. B. B., në DVP-2012, në rubrikën “Të ardhura nga angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, ka deklaruar të ardhurat e të gjithë familjes së tij, përkatësisht: (i) Të ardhurat e tij vjetore nga paga, në shumën 1.079.000 lekë; (ii) Të ardhurat nga paga të bashkëshortes (V.B.), në shumën 343.700 lekë; (iii) Të ardhura vjetore të vajzës E. B., nga paga, përfshirë pagesat për orët jashtë orarit dhe shpërblime vjetore, në shumën 1.129.330 lekë; (iv) Të ardhura ardhurat vjetore të vajzës Eriselda Bala – Ajo bashkëjeton më vete, është subjekt i deklaratimit të pasurisë për shkak të detyrës së saj si prokurore. Ka bërë deklaratimet e pasurisë.

ii. Nëna e subjektit, znj. V. B., në rubrikën “Deklarimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme”, ka deklaruar: (i) Interesa vjetorë nga llogaria e kursimeve në Bankën “ProCredit”, në shumën 144.200 lekë; (ii) Llogaria e kursimeve në Bankën “ProCredit” u mbyll duke hequr prej saj shumën 1.070.000 lekë. Një milion prej saj iu dhanë vajzës Eriselda Bala, për blerjen e shtëpisë.

³³ Shkresë nr. {***} prot. (F. N.), datë 19.01.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe shkresë nr. {***} prot. (P. H.), datë 19.01.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë; Shkresë nr. {***} prot., datë 04.02.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.

³⁴ Depozituar me pyetësin nr. {***}, datë 03.02.2022: i) Shkresë nr. {***} prot., datë 14.02.2022, nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë; ii) Shkresë nr. {***} prot., datë 09.02.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë; iii) Shkresë nr. {***} prot., datë 09.02.2022, nga Komisariati i Policisë Sarandë; iv) Shkresë nr. {***} prot., datë 11.02.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës Shkallës Parë Tiranë.

³⁵ Shkresë nr. {***} prot., datë 09.12.2021.

³⁶ Pyetësor nr. {***}, datë 06.12.2021.

iii. Motra e subjektit, znj. E. B., në rubrikën “Deklarimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme” ka deklaruar: Llogaria Bankare në “Union Bank” është mbyllur. Nga kjo llogari u tërhoqën 1.000.000 lekë. *Kjo shumë i është dhënë motrës sime Eriselda Bala për blerje shtëpie, si borxh brenda familjes.*

15.5. Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të shkaktit të ankimit, që lidhet me verifikimin e ligjshmërisë së shumës prej 1.000.000 lekësh, dhuratë nga nëna e subjektit dhe shumës 1.000.000 lekë, hua nga motra e subjektit, analizoi të dhënat e mësipërme në harmoni me ato që vijnë nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, si deklarimet dhe shpjegimet e subjektit, ashtu edhe lëvizjet bankare, llogarive/depozitave të nënës dhe të motrës së subjektit, si dhe të dhënat e siguruara nga hetimi administrativ, nga të cilat konstatoi se:

Së pari, subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* se si burim për krijimin e pasurisë ka shërbyer, ndër të tjera, shuma prej 1.000.000 lekësh, që nëna e saj i ka dhuruar subjektit, likuiditete të gjeneruara prej llogarisë së saj bankare pranë “ProCredit Bank”. Nga aktet bankare ka rezultuar se nëna e subjektit, znj. V.B., në datën 05.10.2012, nga llogaria e saj pranë kësaj banke, ka tërhequr shumën 1.000.000 lekë. Subjekti ka deklaruar në Komision se, me qëllim mos prishje të interesave të bankës, kjo shumë është marrë hua prej prindërve nga V. L., dhe është përdorur për pagesën e kështit të datës 23.07.2012, të cilën ata ia kanë kthyer pasi nëna tërhoqi lekët në datën 05.10.2012, kur është maturuar depozita. Nga verifikimi i të dhënave bankare rezulton se shuma prej 1.000.000 lekë ka qenë e depozituar pranë “ProCredit Bank”, në një depozitë me afat 1-vjeçar, prej datës 05.10.2011 deri më datë 05.10.2012. Nga verifikimi i *statementeve* bankare, të lëshuara nga “ProCredit Bank”, rezulton se në datën 5.10.2012, nga llogaria e nënës së subjektit, është tërhequr shuma 1.000.000 lekë, ndërsa në llogarinë e burrit hallës, z. V. L., është depozituar shuma 1.000.000 lekë, në të njëjtën datë.

Së dyti, motra e subjektit, znj. E. B., nga verifikimi i *statementeve* të lëshuara nga “Union Bank”, rezulton se ka pasur të depozituara në depozitë 6-mujore shumën 1.000.000 lekë, e cila është maturuar më datë 08.11.2012 dhe është tërhequr nga motra e subjektit nga llogaria e saj më datë 09.11.2012. Subjekti ka deklaruar në Komision se, me qëllim që të mos prishte interesat, motra këtë shumë ia ka marrë hua shtetasit V. L., të cilën ia ka kthyer pasi ajo tërhoqi lekët në datën 09.11.2012, kur është maturuar depozita.

15.6. Për sa më sipër, rezulton se gjatë hetimit administrativ subjekti ka shpjeguar se prindërit dhe motra e saj, për dhurimin e shumave respektive, nga 1.000.000 lekë në korrik të vitit 2012, fillimisht kanë përdorur fondet, të cilat ua ka vënë në dispozicion i afërmi i familjes, z. V. L., që ia kanë kthyer disa muaj më pas, kur motra dhe nëna e subjektit kanë tërhequr fondet e impenjuara në depozitat bankare në “Union Bank” dhe në “ProCredit Bank”. Nisur nga këto shpjegime të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka kryer analizë financiare të z. V. L., duke e konsideruar atë si person tjetër të lidhur (huadhënës) të personave të tjerë të lidhur të subjektit (prindërve dhe motrës), në kuptim të përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Nga kjo analizë, Komisioni, siç ka evidentuar edhe në vendim, ka konkluduar se z. L., dispononte të ardhura të ligjshme për krijimin e shumës 2.000.000 lekë, të dhënë hua prindërve dhe motrës së subjektit.

15.7. Në konsideratë të fakteve si më lart përshkruar, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, duke deklaruar në deklaratën *vetting* dhe në deklarimet periodike të pasurisë, se apartamenti në Tiranë është financuar pjesërisht me dhurimin e shumës 1.000.000 lekë nga prindërit e saj dhe me huan, në të njëjtën vlerë, të marrë nga motra, ka përmbushur detyrimin për deklarimin e burimeve të pasurisë,

si dhe ka ekspozuar ndaj kontrollit personat e tjerë të lidhur, në këtë rast prindërit dhe motra e saj. Fakti që subjekti nuk ka deklaruar në deklarimet periodike dhe në deklaratën *vetting*, burimet e krijimit prej personave të tjerë të lidhur të shumave të dhëna dhuratë apo hua, nuk përbën në vetvete shkeljen e ndonjë detyrimi ligjor, pasi detyrimi i subjektit është plotësuar me deklarimin e prindërve dhe të motrës, si dhurues apo huadhënës me shumat respektive. Subjekti, në këtë rast, ka zgjedhur të jetë koncize dhe brenda limiteve ligjore, pa ekspozuar më shumë se ligji i kërkon. Në këto kushte ishte objekt i hetimit të Komisionit, verifikimi dhe kontrolli i burimeve të prindërve dhe motrës për shumat e kaluara subjektit. Në këtë drejtim, subjekti ka deklaruar në mënyrë konsistente dhe pa devijime, se shuma në total prej 2.000.000 lekësh nga personat e tjerë të lidhur, është siguruar përkohësisht nga një person i tretë, z. V. L., i deklaruar si i tillë gjatë hetimit administrativ në Komision, i cili, për më tepër, ka rezultuar me mundësi financiare për të huazuar shumën të personat e tjerë të lidhur. Kjo situatë nuk prodhon në vlerësimin e trupit gjykues ndonjë shkelje të ligjit prej subjektit të rivlerësimit, për pasojë nuk evidenton ndonjë situatë që e vendos subjektin në kushtet e një deklarimi jo sipas kërkesave të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

15.8. Argumenti i përdorur prej Komisionit, në drejtim të besueshmërisë së deklarimeve të subjektit se, mbetet e paqartë dhe e pakuptueshme përse subjekti nuk ka marrë personalisht hua në vlerën 2.000.000 lekë prej shtetasit V. L., brenda qershorit të vitit 2012, për të shlyer detyrimet e kontratës së sipërmarrjes, vlerësohet prej trupit gjykues, *së pari*, si jo i arsyeshëm, sepse subjekti dhe familja e saj kanë zgjedhur/vendosur të ndihmojnë vajzën e tyre nëpërmjet financimit të deklaruar, duke marrë ata përsipër detyrime ndaj të tretëve, pa përfshirë subjektin në to edhe për shkak të një ekonomie familjare të brishtë të subjektit dhe, *së dyti*, edhe si jorelevant për çështjen në analizë, për sa kohë që subjekti ka qenë koherent në shpjegimet e saj lidhur me këtë situatë dhe marrëdhëniet e prindërve të saj me z. V. L., marrëdhënie të cilat ishin testuar edhe më parë në të njëjtën fushë dhe kishin rezultuar të besuara. Edhe vetë paqartësia e sjellë në vëmendje prej Komisionit ka mbetur pa një pasojë, duke prodhuar ambiguitet mbi pyetjen e ngritur dhe efektin e saj në vlerësimin e deklarimeve të subjektit.

15.9. Në vijim, trupi gjykues i Kolegjit, ashtu si dhe Komisioni, duke i konsideruar prindërit dhe motrën e subjektit si persona të tjerë të lidhur (dhurues dhe huadhënës), sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, verifikoi mundësinë financiare të tyre për të krijuar me burime të ligjshme shumat prej 1.000.000 lekësh, të dhuruara dhe të dhëna hua subjektit, të cilat gjendeshin të depozituara në llogarinë bankare të nënës së saj në “ProCredit Bank” dhe në llogarinë bankare të motrës në Union Bank. Nga analiza e kryer në Kolegj, ashtu si edhe nga ajo e kryer në Komision, rezultoi se prindërit dhe motra e subjektit të rivlerësimit kishin mundësi për të krijuar me burime të ligjshme shumat respektive prej 1.000.000 lekësh, të dhuruara dhe të dhëna hua subjektit.

15.10. Në përfundim, në përmbledhje të sa analizuar më sipër, lidhur me analizën e burimeve të financimit të pjesës takuese prej ½ të apartamentit në Tiranë, të financuar nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues arrin në konkluzionin se:

i. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting*, si një nga burimet e krijimit të pasurisë, dhurimin e bërë nga prindërit e saj dhe huan nga motra, secila në vlerat prej 1.000.000 lekësh, respektivisht. Në këtë mënyrë, subjekti ka plotësuar detyrimin për deklarimin e burimeve të krijimit të pasurisë, një prej të cilave ka qenë edhe dhurimi dhe huaja, pasi ligji nuk parashikon një detyrim për deklarimin në këtë deklaratë edhe të burimit të krijimit të pasurive prej personave të tjerë të lidhur, fakt që duhet të rezultojë i provuar gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

ii. Ka rezultuar e provuar se personat e tjerë të lidhur, familjarë të subjektit të rivlerësimit, kanë përdorur si burim për dhënien dhuratë dhe hua të shumave të deklaruara, të ardhurat e tyre të depozituara në depozita me afat, në “ProCredit Bank” dhe “Union Bank”, të cilat janë tërhequr në ditën e maturimit të tyre dhe brenda vitit 2012. Përdorimi i përkohshëm prej tyre i një huaje të marrë prej z. V. L., i cili ka rezultuar nga hetimi se kishte burime financiare të ligjshme për dhënien e saj, bëhet i besueshëm në konsideratë të disa faktorëve të shpjeguar prej subjektit të rivlerësimit për marrëdhëniet e familjes së saj me të, por edhe nga gjurmët e konstatuara në sistemin bankar, që japin të dhëna për besueshmëri të këtij transaksioni.

15.11. Përfundimet e mësipërme, së bashku me konfirmimin prej Komisionit të burimeve të tjera të deklaruara prej subjektit se kanë shërbyer për financimin e pjesës së saj takuese në apartament, çojnë trupin gjykues në përfundimin se subjekti ka pasur burime të ligjshme për të financuar këtë pasuri lidhur me pjesën e saj takuese.

15.12. Në vijim, trupi gjykues mori në shqyrtim shkakun e ankimit që kundërshton konkluzionet e Komisionit, lidhur me mundësinë e bashkëshortit të subjektit për të financuar me burime të ligjshme pjesën e tij takuese prej ½ të kësaj pasurie, duke konstatuar e analizuar sa vijon:

15.13. Komisioni ka konkluduar se prindërit e bashkëshortit të subjektit nuk kanë pasur mundësi të krijojnë me burime të ligjshme shumat e dhuruara atij në korrik të vitit 2012 dhe, gjithashtu, është konsideruar si e pabesueshme, në mungesë të deklarimeve në DPV-të respektive, që shuma prej 2.022.152 lekësh, e tërhequr prej nënës së personit të lidhur në datën 15.06.2012, të ketë shërbyer për t’ia dhënë atij si dhurim për financimin e pasurisë. Në këto kushte, edhe sikur të pranohej se prindërit kanë pasur mundësi të krijojnë me burime të ligjshme shumën e dhuruar, mbetet e paprovuar se kjo shumë ka shërbyer për financimin e pasurisë.

15.14. Në analizë të kësaj çështje, trupi gjykues i konsideroi deklaratimet e personit të lidhur në deklaratën *vetting*, si të parat deklarime për burimet e krijimit të pasurisë, për shkak të situatës së trajtuar në paragrafët [14.3 - 14.10] të këtij vendimi, duke u fokusuar në verifikimin e vërtetësisë së tyre dhe kontrollin e burimeve të përdorura për dhurimin nga prindërit e personit të lidhur.

15.15. Në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit si burim financimi për apartamentin në Tiranë ka deklaruar *shumën 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë, dhuratë nga prindërit, të tërhequra nga llogaritë e kursimeve të tyre*. Komisioni ka kryer analizën financiare të prindërve të bashkëshortit të subjektit për të krijuar me burime të ligjshme shumat e deklaruara prej tij, si të përdorura për pagesën e kësteve të apartamentit në Tiranë dhe ka evidentuar se, mbështetur në përlllogaritjet e kryera gjatë hetimit administrativ, mundësia e prindërve të bashkëshortit të subjektit për kursim është në vlerën 1.381.025 lekë dhe, për rrjedhojë, prindërit e bashkëshortit janë konsideruar se nuk kanë pasur mundësi për të dhuruar shumën totale prej 2.022.152 lekësh, në qershor të vitit 2012, kur janë tërhequr depozitat³⁷.

15.16. Gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe me ankimin, subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion dhe pretendon se nga Komisioni, në analizën financiare të kryer për prindërit e bashkëshortit, nuk janë marrë në konsideratë një sërë provash që provojnë të ardhurat e tyre nga blegtorja, të cilat janë depozituar gjatë hetimit administrativ. Po ashtu, subjekti pretendon se, në vlerësimin e kryer, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë faktin se të ardhurat e prindërve të

³⁷ Përberë prej 6.600 euro/922.152 lekë, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë + 1.100.000 lekë, tërhequr nga nëna e bashkëshortit në datën 15.06.2012.

bashkëshortit të saj janë krijuar shumë kohë më parë se ajo dhe bashkëshorti të njiheshin, pra janë krijuar larg ndikimit të saj. Për më tepër, subjekti ka potencuar faktin se prindërit e bashkëshortit jetojnë në fshat, në {***} dhe, për periudhën 1994 – 2005, i ati i bashkëshortit ka qenë i regjistruar si i vetëpunësuar në bujqësi. Babai i bashkëshortit, edhe pas daljes në pension, ka vijuar të ushtrojë aktivitetin si fermer, kryesisht me mbarështimin e gjedhëve (dhen dhe dhi), duke disponuar një fermë, që çdo vit ka pasur rreth 100 - 150 krerë. Duke jetuar në fshat, kanë pasur shpenzime jetesë minimale, si dhe të ardhura të kënaqshme nga blegtoria. Subjekti pretendon se prej babait të bashkëshortit janë disponuar gjithmonë rreth 100 - 150 krerë të imta, fakt ky që vërtetohet dhe nga kontratat e dhënies me qira të kullotave nga “Drejtoria e Shërbimit Pyjor Delvinë”, në të cilat qiratë përcaktoheshin duke u bazuar në numrin e kokëve të bagëtisë/gjedhëve që zotëroheshin. Për të provuar këto pretendime, subjekti ka paraqitur në Komision një sërë aktesh, një pjesë e të cilave rezultojnë të jenë krijuar në kohën kur pretendohet se janë gjeneruar këto të ardhura.

15.17. Komisioni, pasi ka analizuar të gjithë dokumentacionin e depozituar nga subjekti, ka arritur në konkluzion se, ndonëse babai i bashkëshortit figuron i vetëpunësuar në bujqësi që prej vitit 1994 deri në 2005 dhe zotëron një fermë blegtorale me rreth 150 krerë të imta, nga e cila ka përfituar të ardhura, duket se nuk provohet me dokumentacion fitimi i realizuar nga ky aktivitet. Në përfundim, prej Komisionit është konkluduar se: *nuk mund të arrihet në konkluzionin se babai i bashkëshortit të subjektit nuk ka siguruar të ardhura nga blegtoria, të cilat kanë reduktuar shpenzimet e jetesës së tyre*. Sipas Komisionit, në kushtet e pamundësisë objektive për të kryer një analizë të mirëfilltë financiare për prindërit e bashkëshortit, është bërë një përllogaritje bazuar në të ardhurat e nënës së bashkëshortit nga paga si infermiere, në vlerën 2.808.817 lekë, për periudhën 1993 – 01.02.2011 dhe shpenzimet e jetesës për dy persona³⁸, duke i reduktuar ato me 50%. Sipas përllogaritjeve të Komisionit, mundësia e prindërve për kursim ka rezultuar në vlerën 1.381.025 lekë, për rrjedhojë është vlerësuar se ata nuk kanë pasur mundësi për t’i dhuruar bashkëshortit të subjektit shumën prej 2.022.152 lekësh, në qershor të vitit 2012, kur janë tërhequr depozitat. Në analizën e Komisionit nuk është përfshirë si burim financimi as shuma prej 1.381.025 lekësh, e cila u provua se ishte e mundur të krijohej nga prindërit e bashkëshortit me të ardhura të ligjshme.

15.18. Në ankim, subjekti kundërshton si të gabuar analizën e mësipërme të Komisionit për të kontrolluar mundësinë e prindërve të bashkëshortit si persona të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të krijuar me burime të ligjshme shumën e dhuruar në total 2.022.152 lekësh, për shkak se: **(i)** nuk janë përfshirë në analizë të ardhurat e siguruara nga aktiviteti i blegtorisë së ushtruar nga B.N., (babai i bashkëshortit të subjektit), sipas vlerës së përcaktuar në vërtetimin nr. {***}, datë 11.02.2022, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë. **(ii)** Në kundërshtim me raste të tjera të ngjashme, Komisioni, për prindërit e bashkëshortit, si persona me burim kryesor të ardhurash nga aktiviteti bujqësor/blegtoral, ka përllogaritur shpenzime jetese në masën 50% të të ardhurave për vitet 1993 – 2000, kur sipas subjektit ato duhet të ishin në masën 30% – 40% të të ardhurave, ndërsa për periudhën 2001 – 2011, për të cilën Komisioni ka aplikuar shpenzime të jetesës sipas ILDKPKI-së, duke i reduktuar ato në masën 50%, sërish subjekti

³⁸ Bashkëshorti i subjektit nuk është përfshirë në këtë analizë, pasi atij i është kryer analiza si person më vete, nga viti 2002, kur ka filluar punë dhe është shkëputur nga prindërit, deri në vitin 2011 (shih paragrafin 38.3 të vendimit). Gjithashtu, nuk janë përfshirë: (i) vëllai i bashkëshortit të subjektit, U. N., i lindur më 11.10.1984, i cili me të ardhura të tij, gjatë viteve që mund të ketë punuar, supozohet se ka përballuar shpenzimet e tij; (ii) motra e tij, E. N., e lindur më 20.06.1991, e cila për shkak të moshës nuk ka punuar dhe së cilës nuk i janë llogaritur shpenzime jetese (shih kartat ID në përgjigje të pyetësorit nr. {***}).

pretendon se duhen reduktuar deri në masën 30 % – 40%. **(iii)** Nuk është përfshirë si e ardhur shuma e pensionit të z. B. N., (vjehtëri i subjektit), i cili sipas subjektit, për periudhën 2005 – 2011 ka marrë pension invaliditeti në masën 16.140 lekë/muaj, me një vlerë totale prej 1.162.080 lekësh. **(iv)** Nuk është konsideruar fakti që bashkëshorti i saj kishte mundësi kursimi deri në shumën 1.230.000 lekë, që do të thotë që bashkëshorti nuk ka qenë në kushtet e një kursimi të limituar, por ka pasur burime të ligjshme të lira, të cilat ia ka vënë në dispozicion familjes së origjinës, me të cilën ai bashkëjetonte asokohe.

15.19. Lidhur me sa referuar më sipër, nga verifikimi i analizës financiare të kryer nga Komisioni për prindërit e bashkëshortit të subjektit, si persona të tjerë të lidhur, *së pari* konstatohet se kufijtë kohorë të kësaj analize përfundojnë në shkurt 2011, afat ky që nuk përkon me kohën e dhurimit të shumës djalit të tyre (qershor 2012), dhe as me datat kur janë krijuar depozitat prej nënës së personit të lidhur, fondet e të cilave, ky i fundit ka deklaruar se janë përdorur për të paguar pjesën e tij takuese të apartamentit në Tiranë. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se analiza financiare e familjes së origjinës së bashkëshortit duhet kryer nga viti 1993, kur ka të dhëna për punësimin e prindërve, e deri në datat e krijimit të depozitave³⁹, të cilat janë deklaruar se kanë mbajtur likuiditetet e dhuruara djalit të tyre. Analiza që ka bërë Komisioni deri në shkurt të vitit 2011, përveç se nuk shtrihet deri në ditën e dhurimit të shumave, qershor 2012, por paraqet edhe një kontradiktë logjike, duke qenë se vetë subjekti dhe personi i lidhur deklarojnë se të ardhurat që janë dhuruar, janë ato të tërhequra nga depozitat e krijuara në vitet 2006 – 2008. Të ardhurat e tjera në vite të familjes së origjinës së personit të lidhur, ndonëse në një kuptim teorik mund të vlerësohen se kanë afektuar situatën financiare të familjes, ato nuk rezultojnë të kenë furnizuar depozitat për shumat e dhuruara, të cilat janë krijuar në mënyrë autonome shumë kohë më parë, edhe se viti 2011, në të cilin ndalet analiza e Komisionit.

15.20. Trupi gjykues, *së dyti*, gjithashtu konstatoi se Komisioni ka kryer një analizë financiare për prindërit e bashkëshortit, duke mos konsideruar faktin që deri në vitin 2008, kur janë krijuar depozitat bankare, por edhe më tej, bashkëshorti i subjektit ka jetuar me prindërit e tij duke kontribuar në ekonominë familjare me të ardhurat e siguruar nga punësimi, mangësi e cila u korrektohet në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj.

15.21. Në reflektim të këtyre qëndrimeve, u krye analiza e prindërve të bashkëshortit të subjektit, për të krijuar shumën e dhuruar në vlerën 2.022.152 lekë me burime të ligjshme deri në 31.03.2008, duke konsideruar si pjesë të familjes/ekonomisë familjare edhe bashkëshortin e subjektit, i cili rezultonte i punësuar nga viti 2002. Në këtë analizë financiare, si të ardhura u përfshinë vetëm të ardhurat e ligjshme për të cilat provohej përfitimi i tyre, që përfaqësoheshin nga të ardhurat nga paga e nënës së personit të lidhur, znj. SH. N., si dhe të ardhurat nga paga e personit të lidhur. Në këtë analizë nuk u përfshinë të ardhurat e pretenduara nga pensioni i invaliditetit të babait të personit të lidhur, z. B. N., meqenëse nga të dhënat e siguruar nga hetimi administrativ evidentohet përfitimi i këtij pensioni vetëm në prill të vitit 2009, periudhë e cila ishte pas marsit të vitit 2008, kur ishte përmbyllur krijimi i depozitave bankare.

³⁹ Nga të dhënat e disponuara në fashikullin e hetimit administrativ të Komisionit rezulton se nëna e bashkëshortit të subjektit, në datën 31.08.2006, ka depozituar në “Raiffeisen Bank”, shumën 500.000 lekë dhe shumën 3.000 euro. Në datën 31.03.2008, këto depozita janë shtuar përkatësisht me vlerat 400.000 lekë dhe 3.000 euro, që së bashku me interesat e përfituara ndër vite, prej 217.149 lekë dhe 630 euro, kanë mbuluar dhurimin e kryer ndaj bashkëshortit të subjektit. Këto depozita janë tërhequr nga banka më datë 15.6.2012, përpara likuidimit të kështit të pretenduar si të paguar nga subjekti në datën 23.07.2012.

15.22. Gjithashtu, Kolegji për shpenzimet e jetesës së periudhës deri në mars të vitit 2008, përdori të njëjtën metodologji të përdorur nga Komisioni, i cili kishte aplikuar reduktime të këtyre shpenzimeve për shkak të jetesës në fshat të prindërve të bashkëshortit, dhe ndërkohë vlerësoi se pretendimet e subjektit për reduktime të mëtejshme të kostove të jetesës nuk ishin të justifikuara dhe reale. Në këtë analizë, për personin e lidhur, në ndryshim nga prindërit e tij, u përlllogaritën shpenzime jetese sipas metodologjisë së Kolegjit, duke mos aplikuar reduktim të këtyre shpenzimeve të ndikuara nga veprimtaria bujqësore dhe blegtorale.

15.23. Nga analiza e kryer sipas kësaj metodologjie, trupi gjykues konstatoi se mundësia për kursim e familjes së origjinës dhe e bashkëshortit të subjektit, më datë 31.08.2006, ishte në shumën 1.706.816 lekë, vlerë e cila konstatohet e mjaftueshme për të krijuar me burime të ligjshme hapjen e depozitave në shumën 500.000 lekë dhe 3.000 euro në këtë datë. Po ashtu, edhe më datë 31.03.2008, mundësia për kursim e kësaj familjeje u përlllogarit në vlerën 1.830.431 lekë, e cila justifikonte kreditimin me burime të ligjshme të depozitave të shtuara në këtë datë, duke arritur me vlerë totale prej 6.000 eurosh dhe 900.000 lekësh.

15.24. Në kushtet kur nga analiza financiare e kryer sipas kësaj metodologjie u konstatua se prindërit dhe bashkëshorti i subjektit kishin burime të ligjshme për krijimin e depozitave dhe për shtesat e tyre, trupi gjykues e konsideroi të panevojshme të ndalej në përlllogaritjen e të ardhurave të siguruara nga kjo familje nga aktiviteti blegtoral, angazhim i cili provohej me dokumente të lëshuara nga institucione publike, larg nisjes së procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit, që i përkisnin periudhës para se subjekti të lidhte martesë me personin e lidhur.

15.25. Në reflektim të sa më sipër, për sa i përket mundësisë së personave të tjerë të lidhur, prindërve të bashkëshortit të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit, duke bërë një analizë dhe vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, pasi e gjeti atë logjikisht të pambështetur, arriti në konkluzionin se rezultoi e besueshme se ata kishin mundësi të krijonin me burime financiare të ligjshme depozitat e përdorura si burim për krijimin e kësaj pasurie, në vitet 2006 dhe 2008, në konsideratë edhe vetëm të të ardhurave të ligjshme të nënës së bashkëshortit dhe atij vetë, gjatë viteve të marra në analizë. Në këtë konkluzion, trupi gjykues konsideroi edhe faktin se këto depozita janë krijuar në vitet e mësipërme, ndërsa subjekti ka filluar punë në vitin 2009 dhe bashkëjetesën me bashkëshortin në vitin 2012.

16. *Trupi gjykues mori në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat kundërshton si jo të drejta dhe si të pabazuara ligjërisht konkluzionet e Komisionit, se ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratat periodike të pasurisë, për shkak të mosdeklarimit në vitet 2013 dhe 2014 të gjendjes së huas të marrë nga motra e saj dhe të deklaruar si të tillë në deklaratën e vitit 2012, për të cilat analizon sa vijon:*

Lidhur me këtë çështje, Komisioni ka arsyetuar se: [...] nga vëzhgimi i DPV-ve vërehet se, ndërsa mungon të ketë kryer deklarime në lidhje me detyrimin financiar ndaj motrës së saj, E. B., në DPV-të e viteve 2013 dhe 2014, subjekti ka kryer deklarime të sakta në lidhje me dy kredi konsumatore të marra në vitin 2012, duke deklaruar saktësisht përkatësisht shlyerjen e kësteve takuese, si dhe detyrimin e mbetur në DPV-të për vitet 2012 dhe 2013, e duke vijuar me vitin 2014, kur ka deklaruar shlyerjen përfundimtare të detyrimeve financiare dhe gjendjen 0 (zero) të tyre. Në këto kushte, mungesa e deklarimit të detyrimeve financiare për shkak të huas objekt verifikimi në DPV-të e viteve 2013 dhe 2014, e bëjnë të pabesueshme një harresë të mundshme nga subjekti, duke i bërë këto deklarime të pasakta në kuptim të ligjit dhe, nga ana tjetër, i bëjnë të dyshimta deklaramet dhe

veprimet e mëvonshme të subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, nga analiza financiare e viteve 2013 dhe 2014, vite në të cilat subjekti nuk e ka deklaruar detyrimin financiar, subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të mundësuar shlyerjen e huas me të ardhura të ligjshme. Pavarësisht se subjektit nuk i janë kërkuar sqarime gjatë procesit në lidhje me pasaktësitë në DPV-të e viteve 2013 dhe 2014, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni nuk mund të anashkalonte rrethanat e sipërpërmendura, të cilat i ka mbajtur në konsideratë në procesin e vendimmarrjes, duke i vlerësuar në raport me rrethanat të tjera të evidentuara në përfundim të këtij procesi, që kanë lidhje me kriterin pasuror [...].

16.1. Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues mori në shqyrtim deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, si dhe deklaratat periodike të pasurisë. Nga këto deklarime rezultoi se, në DVP-2012, subjekti ka deklaruar marrjen e huas në vlerën 1.000.000 lekë nga motra e saj, e cila është përdorur për pagesën e çmimit të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes lidhur për apartamentin. Në DVP-2012 dhe DVP-2013, subjekti *nuk* ka deklaruar asgjë lidhur me këtë hua. Në DVP-2015, ajo deklaroi se: *“huaja e marrë motrës sime E. B., prej 1.000.000 lekësh, e pashlyer ende”*, deklarim i cili është bërë edhe në DPV-2016 e DVP-2017. Deklarime të bëra prej subjektit për mosshlyerjen e huas në këto vite, duket se kanë sjellë në vëmendje të Komisionit faktin se ajo nuk e ka deklaruar këtë fakt në DVP-2012 dhe DVP-2013. Ndërkohë, trupi gjykues konstaton se kjo hua rezulton se është deklaruar e pashlyer nga subjekti edhe në deklaratën *vetting*, po ashtu edhe me shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, subjekti ka shpjeguar se shlyerja e kësaj huaje është bërë me transfertë bankare prej saj te motra, në vitin 2020.

16.2. Në momentin e marrjes së kësaj huaje, pra në vitin 2012, rezulton se subjekti në deklarinë periodik të këtij viti, e ka deklaruar këtë hua si burim të financimit të apartamentit në Tiranë. Subjekti ka deklaruar në vijim sipas kërkesave të ligjit nr. 9049/2003, në zbatim të të cilave ajo ka pasur detyrimin për të deklaruar vetëm ndryshimet në interesat e saj private në vitet kalendarike respektive. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se, për periudhën 2012 deri 2018, gjatë së cilës subjekti nuk ka kryer deklarime për shlyerjen e huas, në kushtet kur rezulton se kjo marrëdhënie nuk ka pësuar ndryshime që nga deklarimi i vitit 2012, nuk ka ekzistuar as detyrimi për të deklaruar çdo vit gjendjen e pandryshuar të kësaj huaje.

Vetëm fakti që në DVP-2015 e në vijim, subjekti ka bërë deklarinë se huaja ndaj motrës ka mbetur ende e pashlyer, në përgjigje të tërheqjes së vëmendjes pas pyetjes në ILDKPKI, në vitin 2014, nuk vlerësohet se provon deklarinë e pasaktë në DPV-të e viteve 2012 dhe 2013, në të cilat nuk ka deklarime rreth saj. Vetëm nëse subjekti do të kishte shlyer në vitet 2013 e 2014 pjesë nga huaja e marrë motrës së saj dhe nuk do t'i kishte deklaruar këto shlyerje/pagesa në deklaratimet përkatëse të pasurisë të këtyre viteve, atëherë do të vlerësohej se situata e vendoste subjektin në kushtet e një deklarimi të pasaktë të bërë në deklaratimet periodike. Në këtë kuptim, edhe arsyetimi i Komisionit se: *për më tepër, nga analiza financiare e viteve 2013 dhe 2014, vite në të cilat subjekti nuk e ka deklaruar detyrimin financiar, subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të mundësuar shlyerjen e huas me të ardhura të ligjshme*, duket se është një konstatim që nuk përputhet me situatën faktike dhe i panevojshëm për t'u analizuar më tej, për sa kohë subjekti, në asnjë rast, qoftë edhe gjatë hetimit administrativ, nuk ka pretenduar shlyerje të huas ndaj motrës në vitet 2013 dhe 2014, pasi ajo, në përgjigjet e pyetësorit nr. {***}, i ka shpjeguar Komisionit se huaja është shlyer tërësisht prej saj nga viti 2018 deri në vitin 2020.

- 16.3. Për sa më sipër, trupi gjykues konstaton të gabuar konkluzionin e Komisionit, se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratat periodike të pasurisë, për shkak të mosdeklarimit në vitet 2013 dhe 2014 të gjendjes së huas të marrë nga motra e saj dhe të deklaruar si të tillë në deklaratën e vitit 2012. Trupi gjykues vlerëson se ky konstatim, jo vetëm që nuk mund të jetë një shkak për shkarkim, por ai nuk mund të afektojë vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit, për shkak se nuk konstatohet ndonjë shkelje ligjore në mosdeklarimin e kësaj huaje në vitet vijuese, në të cilat kjo marrëdhënie detyrimi nuk ka pësuar asnjë ndryshim nga deklarimi i mëparshëm i saj.
17. Në përfundim, trupi gjykues kontrollon në tërësi analizën financiare të kryer nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur, për periudhën e rivlerësimit 2008 – 2016. Në këtë analizë⁴⁰, trupi gjykues reflektoi të gjitha konkluzionet e mësipërme lidhur me burimet e financimit të pasurive të deklaruar nga subjekti në deklaratën *vetting* për automjetin “Mercedes Benz”, si dhe për apartamentin në Tiranë, për të cilin gjithashtu kreu analizën, duke pranuar pagimin/shlyerjen e kësteve të apartamentit sipas përcaktimeve të kontratës së sipërmarrjes, të provuara nga mandatarkëtimet. Nga analiza e kryer sipas kësaj metodologjie, trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në 23 korrik 2012, kur është paguar pjesa më të madhe e çmimit të kësaj pasurie, kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar investimet dhe kostot e jetesës.
18. Trupi gjykues, gjithashtu, në vijim të këtij arsyetimi konstaton të gabuar edhe konkluzionin e Komisionit, se *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë* të burimeve të krijimit të apartamentit në Tiranë, në kushtet kur ky konkluzion mbështetej në qëndrimet e Komisionit rreth vlerës provuese të mandatpagesave dhe analizës mbi burimet e krijimit të kësaj pasurie, të cilat u konsideruan të padrejta sipas arsyetimit më sipër.
19. Për sa më lart, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe, në konsideratë të konkluzioneve të Komisionit për një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1, gerrat “b” dhe “c”, të po këtij ligji, vlerëson se vendimi i Komisionit objekt gjykimi duhet të ndryshohet dhe subjekti të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

⁴⁰ Në analizën financiare të kryer në Kolegj për apartamentin në Tiranë u pranua se pagesat e tij ishin realizuar me tri këste, sipas përcaktimeve të kontratës së sipërmarrjes, dhe se kësti i dytë, i cili përfaqësonte edhe vlerën më të madhe të kësaj pasurie, në shumën 39.000 euro, ishte paguar më datë 23.07.2012, fakt ky i provuar nga mandatarkëtimi i lëshuar nga shoqëria e ndërtimit. Analiza e Kolegjit e kryer në këtë datë përfshiu si burime financimi të gjitha burimet e të ardhurave të deklaruar nga subjekti për këtë pasuri në deklaratën *vetting*, të cilat provoheshin të ishin krijuar me burime të ligjshme.

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 523, datë 07.04.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Eriselda Bala.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 16.01.2025.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi